



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BRENDSHME**  
**AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE**

**Nr. 51/29 Prot.**

**Tiranë më, 19/09/2024**

**V E N D I M**

**Nr. 42, datë 19.09.2024**

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

**Bora Vrenjo**      **Kryesuese**  
**Henri Naqellari**      **Relator**  
**Loreta Hanxhari**      **Anëtare**

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, Znj. Lediana Azemaj, në orën 09:00, datë 19.09.2024, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I VLERËSIMIT:**

**Z. Elton Dilaver Alushi**, me funksion Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

**OBJEKTI:**

**Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, (këtu e në vijim Ligji nr. 12/2018, i ndryshuar).

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,**

pasi dëgjoi relatimin e relatorit të çështjes Henri Naqellari, dëgjoi subjektin e vlerësimit Z. Elton Dilaver Alushi, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 06.09.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 2, nenit 4 dhe nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, Z. Elton Alushi është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023, si Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
3. Subjekti i vlerësimit, **Z. Elton Alushi**, i’u nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
4. Në zbatim të legjisllacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me Vendimin nr. 1, datë 02.08.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit e përbërë nga: Z. Henri Naqellari Relator, Znj. Bora Vrenjo Kryesuese dhe Znj Loreta Hanxhari Anëtare.
5. Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin nr. 1, datë 02.08.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi.
6. Relatori i çështjes, Z. Henri Naqellari, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 03.08.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka dërguar deklaratën e konfliktit të interesit më datë 04.08.2023, duke u shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Relatori i çështjes, në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
10. Bazuar në nenin 34, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar, janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Këto raporte janë administruar nga relatori, me fillimin e hetimit administrativ.
11. Në përputhje me nenin 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI, me shkresë nr. \*\*\*, datë 25.03.2024 (protokolluar me tonën nr. \*\*\*, prot datë 02.04.2024), dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të vlerësimit Z. Elton Alushi. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri është konstatuar se:
  - Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
  - Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - Nuk është kryer fshehje e pasurisë;
  - Nuk është kryer deklarim i remë;
  - Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
12. Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i vlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 42, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 05.02.2024, ka dërguar raportin e saj për subjektin e vlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar se për subjektin e vlerësimit Elton Alushi, nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që të tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
13. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke analizuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i vlerësimit gjatë periudhës objekt

vlerësimi, të dhënat e mbledhura në institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të nenit 46, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, me shkresë nr. \*\*\*, prot datë 01.09.2023, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e vlerësimit, në përfundim të të cilit ka konkluduar se:

- Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
- Ka aftësi në zbatim të detyrave sipas përkrahjeve të punës;
- Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.

14. Në vijim relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi tre kriteret: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

15. Trupa e Vlerësimit, më datë 08.07.2024, pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi, me Vendimin nr. 3, datë 08.07.2024, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

✚ *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*

✚ *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, nenet 35-40 dhe nenet 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 7 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

16. Subjekti i vlerësimit nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për të dhënë shpjegime të tjera me shkrim dhe për tu njohur me dosjen.

17. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

## II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i vlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike, me njoftimin e bërë elektronikisht me email, në datën 03.09.2024.

19. Seanca dëgjimore me subjektin e vlerësimit, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën 06.09.2024, ora 11:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, në prani të sekretariatit teknik.

20. Gjatë seancës dëgjimore, anëtarja e Trupës së Vlerësimit i është drejtuar me një pyetje subjektit të vlerësimit, trajtuar dhe pasqyruar në vendim.
21. Subjekti i vlerësimit Z. Elton Alushi, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur opinionin individual në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim, subjekti kërkoi nga Trupa e Vlerësimit konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT**

22. Subjekti i vlerësimit Z. Elton Alushi, ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.
23. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I VLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT**

24. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
- Vlerësimin e pasurisë;
  - Kontrollin e figurës;
  - Vlerësimin e aftësive profesionale.
25. Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
- Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar;
  - Ligjin nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
  - Ligjin nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
  - Ligjin nr. 49/2012, “Për Gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”;
  - Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
  - Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”;
  - Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”;
  - Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
  - Provat dhe shpjegimet e subjektit të vlerësimit;
  - Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit;
  - Raportin e dorëzuar nga ILDKPKI;
  - Raportin e dorëzuar nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë AMP-së;

- Raportin e dorëzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Deklarata e Pasurisë;
- Deklarata për Kontrollin e Figurës;
- Formulari i Vlerësimit Profesional;
- Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

- 26.** Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklaratimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
- 27.** Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit **Z. Elton Alushi**, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë, brenda afateve të përcaktuara dhe mban nr. index 04, viti 2023.
- 28.** Procedurat e deklaratimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe nenit 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- 29.** Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
- 30.** Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të nenit 33/1 dhe nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

### **Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si dhe përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

### **Hetimi administrativ konsistoi në:**

- ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ Verifikimin e burimit të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe rasteve të konfliktit të interesit.

## **Deklarimi i pasurisë**

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/a, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, në pronësi, në posedim, në përdorim, ose të tjetërsuara nga subjekti i vlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose me persona të tjerë si më poshtë:

- pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to;
- sendet me vlerë të veçantë mbi 300.000 lekë;
- vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- vlerën e likuiditeteve, gjendje në kesh jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari, në huadhënie, apo mjete të tjera financiare, në lekë ose në valutë të huaj;

Në deklaratën Veting, të dorëzuar në strukturat përgjegjëse, subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë pasuritë si në vijim:

1. Apartament në adresën, rr. “\*\*\*\*”, Kompleksi \*\*\*\*”, objekti nr. \*\*\*, kati i \*\*\*, hyrja \*\*\*, me sipërfaqe 63, 5 m<sup>2</sup>, së bashku me 7 metër sipërfaqe e përbashkët. Blerë sipas kontratës së porosisë nr. rep., \*\*\* dhe nr. kol., \*\*\*, datë 22.08.2018. Vlera është 55.000 euro. Pjesa takuese: 100%.
2. Garazh me sipërfaqe 30 m<sup>2</sup>, në objektin \*\*\*, Kompleksi \*\*\*\*, nr. \*\*\*, në rr. “\*\*\*\*”. Vlera: 8.000 euro. Pjesa takuese: 100%.

## **Burimi i krijimit:**

- ✓ Kursimet familjare nga pagat e mia e të bashkëshortes Elsa Alushi, transferuar nëpërmjet bankës Raiffeisen, në vlerën 3.100.000 lekë;
- ✓ Marrja e detyrimeve nëpërmjet huave ndaj A. F, në shumën 15.000 usd dhe 6.000 euro. Sipas kontratës noteriale;
- ✓ Marrja e detyrimeve nëpërmjet huave ndaj B. C, në shumën 950.000 lekë. Sipas kontratës noteriale;
- ✓ Marrja e një sasive prej Dilaver Alushi (kursime në bankë), nëpërmjet Raiffeisen Bank prej 603.000 lekë;

- ✓ Përfitime nga diferenca e shitjes së automjetit Mercedes Benz me targë AA \*\*\* KM, për 2.700 euro;
- ✓ Shitja e pasurisë apartament banimi, me sip. 110 m<sup>2</sup>, rr. “\*\*\*\*”, tek A. N, sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., dhe nr. kol., \*\*\*, datë 03.04.2019, në vlerën 6.700.000 lekë.

**Bashkëlidhur deklaratës:**

- Certifikatë regjistrim pronësie datë 09.09.2021, në emër të Elton Alushi, ku figuron e regjistruar pasuria e llojit apartament, me sip. 63, 5 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale. \*\*\*, pasuri me nr. \*\*\*, në Tiranë, rr. “\*\*\*\*”, me numër apartamenti \*\*\*.
- Kontratë datë 09.07.2021, me palë shitëse “\*\*\*\* sh.p.k” dhe palë blerëse Elton Alushi, të apartamentit nr. \*\*\*, me sip. 63, 5 m<sup>2</sup>, sip. e përbashkët 7 m<sup>2</sup>, në rr. “\*\*\*\*” (emri i tanishëm), objekti \*\*\*, kati i \*\*\*, hyrja \*\*\*, me numër pasurie \*\*\*, në Zonën Kadastrale. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, Tiranë.
- Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 22.08.2018, me palë porositëse Elton Alushi dhe shoqëria ndërtuese “\*\*\*\* sh.p.k”, për porositjen e një apartamenti në rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 70, 5 m<sup>2</sup>, nga e cila 63, 5 m<sup>2</sup> sipërfaqe e hipotekueshme, në objektin \*\*\*, kati i \*\*\* i banimit, si dhe një vend parkim i hapur në katin -2, me sipërfaqe të përgjithshme 27, 5 m<sup>2</sup>, në vlerën 60.000 euro. Shuma 58.000 euro do të shlyhet me këste, deri në dorëzimin për banim të apartamentit, ndërsa shuma 2.000 euro do të shlyhet në momentin e hartimit të kontratës së shitjes dhe regjistrimit në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Apartamenti do të dorëzohet në datë 31.12.2018.
- Certifikatë regjistrim pronësie datë 09.09.2021, në emër të Elton Alushi, ku figuron e regjistruar pasuria e llojit garazh, me sip. 30 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale \*\*\*, pasuri me numër \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.
- Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme, nr. \*\*\*, datë 09.07.2021, me palë shitëse “\*\*\*\* sh.p.k” dhe palë blerëse Elton Alushi, të garazhit në katin -2, me nr. \*\*\*, me sip. 30 m<sup>2</sup>, në adresën në rr. “\*\*\*\*”, me numër pasurie \*\*\*, në Zonën Kadastrale \*\*\*, në vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, Tiranë, në vlerën 8.000 euro ose ekuivalenti 1.050.000 lekë. Çmimin e shitjes, blerësi e ka likuiduar sipas kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 22.08.2018.
- Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 20.08.2018, me deklarues B. C dhe Elton Alushi, ku Elton Alushi deklaroi se më datë 20.08.2018, do të marrë borxh nga deklaruesi B. C vlerën prej 950.000 lekë, jashtë zyrës noteriale, me të drejtë kthimi në datë 20.08.2025, me qëllim blerjen e një pasurie të paluajtshme të llojit apartament, në Tiranë. Shuma do të kalojë nëpërmjet llogarisë bankare pranë Raiffeisen Bank, nga z. B. C.
- Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 17.08.2018, me deklarues Elton Alushi dhe A. F, ku Elton Alushi deklaroi se do të marrë në formë huaje në datë 17.08.2018, kunatit të tij shtetasit A. F, shumën prej 6.000 euro dhe 15.000 usd. Kjo shumë do të jepet hua nëpërmjet bankës, pa interes dhe me një afat shlyerje 5 vjeçar, nga data e nënshkrimit të deklaratës, me qëllim blerjen e një apartamenti në Tiranë. Deklaruesi A. F deklaroi se këto të ardhura i ka siguruar nga shitja e një apartamenti në pronësi të tij.

**Procedura e vlerësimit:**



**Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.09.2023, konfirmon se në emër të Elton Alushi, figuron e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, vol.\*\*\*, fq. \*\*\*, Zona Kadastrale \*\*\*, lloji i pasurisë apartament, me sip. 63, 2 m<sup>2</sup>, përfituar me kontratë shitje (marrë nga referenca nr. \*\*\*).

Gjithashtu në emër të Elton Alushi figuron e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, Zona Kadastrale \*\*\*, lloji i pasurisë garazh, me sip. 30 m<sup>2</sup>, përfituar me kontratë shitje (marrë nga referenca nr. \*\*\*). Bashkëlidhur kopje të praktikave, konkretisht:

- Kartelë e pasurisë së paluajtshme në emër të Elton Alushi, ku figuron e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, Zona Kadastrale \*\*\*, adresa rr. “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, lloji i pasurisë apartament me sip. 63, 2 m<sup>2</sup>, regjistruar në datë 09.09.2021.
- Kartelë e pasurisë së paluajtshme në emër të Elton Alushi, ku figuron e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, Zona Kadastrale \*\*\*, adresa rr. “\*\*\*\*”, lloji i pasurisë garazh, me sip. 30 m<sup>2</sup>, regjistruar në datë 09.09.2021. Vlera fillestare 1.050.000 lekë.
- Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 22.08.2018, me palë porositës Elton Alushi dhe shoqëria ndërtuese “\*\*\*\* sh.p.k”.
- Kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\*, datë 09.07.2021, me palë shitëse “\*\*\*\* sh.p.k” dhe palë blerëse Elton Alushi, të apartamentit nr. \*\*\*, me sip. 63.5 m<sup>2</sup> + 7 m<sup>2</sup> sip. e përbashkët, në rr. “\*\*\*\*” (emri i tanishëm), objekti \*\*\*, kati \*\*\*, hyrja \*\*\*, me numër pasurie \*\*\*, Zona Kadastrale \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, Tiranë, në vlerën 55.000 euro. Çmimi i shitjes është likuiduar nga pala blerëse sipas kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 22.08.2018. Bashkëlidhur Certifikatë për vërtetim pronësie në emër të shoqërisë “\*\*\*\* sh.p.k”, si dhe kartelë e pasurisë së paluajtshme.
- Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 09.07.2021, me palë shitëse “\*\*\*\* sh.p.k” dhe palë blerëse Elton Alushi, të garazhit në katin -2, me nr. \*\*\*, me sip. 30 m<sup>2</sup>, në adresën në rr. “\*\*\*\*”. Bashkëlidhur praktika e shoqërisë.

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare të Elton Alushi, në monedhën lekë, euro dhe usd, ku rezultojnë veprimet si më poshtë:

#### Monedha lekë:

- Në datë 14.08.2018, kredituar llogaria në vlerën 603.000 lekë, nga Dilaver Alushi.
- Në datë 17.08.2018, kredituar llogaria në vlerën 2.044.500 lekë, transfertë nga Elsa Alushi.
- Në datë 20.08.2018, kredituar llogaria në vlerën 950.000 lekë nga B. C, me përshkrimin “dhënie borxh për blerje shtëpie”.
- Në datë 22.08.2018, debituar llogaria në vlerën 4.710.050 lekë, me përfitues “\*\*\*\* sh.p.k”, me përshkrimin “kalim kësti për blerje apartamenti sipas kontratë porosisë datë 22.08.2018, nr. \*\*\*, porositësi Elton Alushi.
- Në datë 18.10.2018 është disbursuar kredia bankare në vlerën 800.000 lekë.
- Në datë 04.04.2019, kredituar llogaria në vlerën 1.750.000 lekë nga A. N, kalim fondi sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 03.04.2019.
- Në datë 04.04.2019 likuiduar kredinë bankare në shumën 742.551 lekë.

- Në datë 06.07.2020, kredituar llogaria nga transferta, në vlerën 4.596.150 lekë, kalim fondi nga llogaria e tij në OTP Bank.
- Në datë 08.07.2020, debituar llogaria në vlerën 5.900.050 lekë, kalim për këmbim.

#### Monedha euro:

- Në datë 20.08.2018, kredituar llogaria në vlerën rreth 6.000 euro nga A. F, kalim sipas deklaratës me nr. \*\*\*, datë 17.08.2018.
- Në datë 22.08.2018, debituar llogaria në vlerën 7.398 euro me përfitues “\*\*\*\* sh.p.k”, me përshkrimin “kalim kësti për blerje apartamenti sipas kontratë porosisë datë 22.08.2018, nr. \*\*\* kol., porositësi Elton Alushi”.
- Në datë 08.07.2020, kredituar shuma 41.504 euro, me kurs 124.2 lekë.
- Në datë 01.07.2021, debituar llogaria në vlerën 5.000 euro, me përfitues “\*\*\*\* sh.p.k”, me përshkrimin “kalim kësti për blerje apartamenti sipas kontratë porosisë datë 22.08.2018, nr. \*\*\*, porositësi Elton Alushi”.

#### Monedha usd:

- Në datë 20.08.2018, kredituar llogaria në vlerën 14.914,75 usd, nga A. F, me përshkrimin “kalim sipas deklaratës me nr. \*\*\*, datë 17.08.2018”.
- Në datë 22.08.2018, debituar llogaria në vlerën 14.914 usd, me përfitues “\*\*\*\* sh.p.k”, me përshkrimin “kalim kësti për blerje apartamenti sipas kontratë porosisë, datë 22.08.2018, nr. \*\*\* kol., porositësi Elton Alushi”.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjekti u pyet në lidhje me burimin financiar për blerjen e apartamentit me sip. 63, 5 m<sup>2</sup>, rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, si dhe dokumentacionin e dorëzuar.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti ka sqaruar se pagesat ndaj firmës së ndërtimit “\*\*\*\* sh.p.k”, janë shlyer nëpërmjet transaksioneve bankare, konkretisht në Raiffeisen Bank, në disa këste, në monedhën euro, lekë dhe usd, ku paraqiti një pjesë të transaksioneve bankare në Raiffeisen Bank, konkretisht: në datë 22.08.2018, shumat 14.914 usd dhe rreth 4.710.000 lekë, në datë 01.07.2021, shuma prej 5.000 euro. Shtoi se në datë 22.08.2018, nga llogaria e tij është paguar edhe shuma rreth 7.400 euro për shoqërinë “\*\*\*\* sh.p.k”. Referuar dy kontratave përfundimtare vlera e paguar nga subjekti me dakordësinë e dy palëve është 63.000 euro.

Për shumën 3.100.000 lekë, si burim financiar kanë shërbyer kursime familjare të pagave të subjektit dhe të bashkëshortes.

Huaja që subjekti ka marrë nga kunati i tij A. F, në shumën prej 15.000 usd dhe 6.000 euro, sipas deklaratës noteriale të dorëzuar, ka burim shitjen e një apartamenti.

Huaja që subjekti ka marrë nga baxhanaku i tij B. C, sipas kontratës noteriale dorëzuar në shumën 950.000 lekë, ka burim financiar kursimet nga paga e tij. Për shumën prej 603.000 lekë, të transferuar nga llogaria bankare e babait pranë bankës Raiffeisen, ka burim financiar kursimet familjare ndër vite të prindërve. Sqaroi se ka deklaruar të ardhura nga shitja e automjetit Mercedes

Benz me targë AA \*\*\* KM për shumën 2.700 euro, për të plotësuar ndonjë diferencë të vogël, (nuk i kujtohet sa ka qenë ekzaktesisht vlera e përdorur).

Subjekti shtoi se përse i përket numrit të pasurisë së garazhit, është i njëjti me atë që i është përcaktuar në kontratën e porosisë në vitin 2018, dhe referuar kontratës përfundimtare mendon që firma ka bërë një lapsus në material. Në dokumentin e dorëzuar nga ai, kjo pasuri figuron e regjistruar me nr. \*\*\*.

Në lidhje me sipërfaqen e garazhit nga 27, 5 m<sup>2</sup>, në sip. 30 m<sup>2</sup>, ndryshimi ka të bëjë vetëm me ri matjen e sipërfaqes së saj, pasi në momentin fillestar, objekti ka qenë në proces ndërtimi, nuk ka ndryshuar vendndodhja e saj, por vetëm sipërfaqja.

Në lidhje me shpenzimet për mobilimin e apartamentit, janë mbajtur disa fatura nga subjekti të cilat janë në shumën rreth 455.000 lekë. Shuma e mobilimit është në vlerën rreth 800.000 lekë, me burim financiar kredinë bankare në Raiffeisen Bank, të disbursuar në datë 17.10.2018, ku në llogarinë e subjektit është kredituar shuma 800.000 lekë, e cila është marrë si kredi konsumatore e përdorur për mobilim. Në datë 04.04.2019 subjekti ka likuiduar para afatit kredinë bankare në shumën 742.551 lekë, me burim nga shitja e apartamentit, konkretisht nga kreditimi në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank, në shumën 1.750.000 lekë, nga A. N. **Paraqiti:**

- Kopje të transaksionit datë 22.08.2018, shuma 14.914 usd, me përshkrimin “kalim kësti për blerje apartamenti”.
- Njoftim debitimi datë 01.07.2021, në Raiffeisen Bank, nga Elton Alushi, të shumës 5.000 euro me përfitues “\*\*\* sh.p.k”, me përshkrimin “kalim kësti për blerje apartamenti, sipas kontratë porosisë nr. \*\*\*, datë 22.08.2018, porositësi Elton Alushi”.
- Kopje të transaksionit datë 22.08.2018, shuma 4.710.000 lekë, me përshkrimin “kalim kësti për blerje apartamenti”.
- Kopje të transaksionit datë 14.08.2018, shuma 603.000 lekë, me përshkrimin “kalim në llogari të djalit”.
- Faturë tatimore nr. 99, datë 19.12.2018, me blerës Elton Aushi, për blerje pajisje elektroshtëpiake, në vlerën 666.7 euro, e konvertuar në shumën 99.200 lekë, bashkëlidhur faturë shitje analitike.
- Faturë tatimore nr. 282165014, datë 21.01.2019, me blerës Elton Aushi, për blerje pajisje shtëpiake në shumën 50.080 lekë.
- Faturë e thjeshtë për mobilim, nga shitësi D. M, me NIPT L\*\*\*U, me blerës Elton Aushi, për blerje mobilje në shumën 305.000 lekë.
- Kontratë kredi bankare, datë 17.10.2018, pranë Raiffeisen Bank dhe kredi marrës Elton Alushi të shumës 800.000 lekë, me afat 48 muaj.

Trupa e Vlerësimit me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare, si dhe vlerësimin e mundësisë për kursim të subjektit të vlerësimit dhe bashkëshortes, ka vlerësuar të dhënat financiare të subjektit të vlerësimit dhe familjes së tij, të vëna në dispozicion në funksion të hetimit administrativ.

Gjithashtu është vlerësuar dokumentacioni i administruar mbi të ardhurat e shtetasit B. C dhe A. F, (trajtuar më poshtë).

### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se:

- *Pasuritë e paluajtshme janë përfituar me kontratë sipërmarrje të vitit 2018 dhe kontratë përfundimtare shitje në vitin 2021, me çmim 63.000 euro, deklaruar me burim të ardhurat nga pagat, huatë dhe kursimet e prindërve.*
- *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.*
- *Subjekti dhe shpjegime dhe paraqiti dokumentacion, në lidhje me burimin financiar për blerjen e pasurive të paluajtshme në Tiranë, në shumën totale prej 63.000 euro.*
- *Shpenzimet e mobilimit të apartamentit janë deklaruar në shumën 800.000 lekë, (për të cilat janë paraqitur një pjesë të faturave), me burim kredi konsumatore në Raiffeisen Bank.*
- *Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, me qëllim blerjen e aseteve.*
- *Pagesa e detyrimeve tatimore lidhur me të ardhurat nga shitblerja e apartamentit të ndodhur në rr. “\*\*\*\*”, është trajtuar më poshtë.*

2. Apartament banimi me sip.110 m<sup>2</sup>, rr. “\*\*\*\*”, në vlerën 52.800 euro.

Burimi i krijimit: Vlera 2.600.000 lekë, të ardhura nga familja, (shitja banesës, tokë Lulëzim Tepelenë, shitja e tokës arë në fshatin Prush, Tiranë, me vlerë 1.000.000 lekë), të ardhura familjare në vitet 2000 - 2007 dhe 22.000 euro kredi bankare nga Tirana Bank, sipas kontratës së datës 20.11.2007. **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 19.06.2007, me sipërmarrës firma “\*\*\*\*” sh.p.k dhe porositës Elton Alushi, të apartamentit nr. \*\*\*, shkalla \*\*\*, e përberë 2+1, kati \*\*\*, me sip. 110 m<sup>2</sup> (së bashku me pjesën e përbashkët), në adresën Kashar, Tiranë, në vlerën 52.800 euro. Me nënshkrimin e kontratës likuidoi shumën 24.350 euro, dhe kësti i dytë me marrjen e hipotekës së apartamentit.
- Kontratë kredi bankare për blerje shtëpie, nr. \*\*\*, datë 20.11.2007, nga Tirana Bank, me palë kredi marrëse Elton Alushi dhe Elsa Alushi, të shumës 22.000 euro me qëllim blerjen e një apartamenti me afat 20 vjeçar. Kredia do të sigurohet mbi vërtetimin për certifikatë provizore regjistrim hipoteke nr. \*\*\*, datë 19.07.2007, në Zonën Kadastrale \*\*\*, me sip. 110 m<sup>2</sup>, godinë në Yzberisht, Kashar, në emër të firmës “\*\*\*\*” sh.p.k.
- Kontratë kalim të drejtash nr. \*\*\*, datë 03.04.2019, me palë të parë Elton Alushi dhe Elsa Alushi, palë e dytë A. K dhe A. N dhe palë e tretë shoqëria ndërtuese “\*\*\*\* sh.p.k”. Poseduesit “Alushi”, në bazë të kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 19.06.2007, të lidhur me ndërtuesin “\*\*\*\* 05 sh.p.k”, që kanë në pronësi dhe në posedim apartamentin nr. \*\*\*, e përbërë 2+1, kati \*\*\*, me sip. të përgjithshme 110 m<sup>2</sup>, sipërfaqe shfrytëzuese 100 m<sup>2</sup>, e përbashkët 10 m<sup>2</sup>, në

Yzberisht, Kashar, Tiranë. Poseduesit i'a shesin apartamentin, shtetasve A. K dhe A. N, në shumën 7.200.000 lekë, duke vënë në dijeni shoqërinë e ndërtimit “\*\*\* sh.p.k”. Pagesa do të kryhet me këste, ku vlera 1.900.000 lekë do të likuidohet nëpërmjet bankës ditën e sotme. Vlera 5.300.000 lekë do të likuidohet në momentin e marrjes së kredisë nga banka. Afati për likuidimin e shumës do të jetë 4 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

- Lëvizjet e llogarisë bankare në OTP Bank, datë 02.07.2020, në emër të Elton Alushi, ku në datën 01.07.2020 është kredituar shuma 4.948.000 lekë nga A. K dhe A. N, pagesë përfundimtare sipas kontratës së kalimit të drejtave nr. \*\*\*, datë 03.04.2019.
- Depozitim në llogari personale në Raiffeisen Bank, datë 04.04.2019, në emër të A. N të shumës 1.750.000 lekë, me burim kursime familjare.
- Kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 25.04.2006, me palë shitëse Dilaver Alushi dhe palë blerëse E. B, të një trualli me sip. 300 m<sup>2</sup>, mbi të cilin ngrihet një shtëpi banimi me sip. 112.7 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, në Zona Kadastrale \*\*\*, vol. \*\*\*, fq.\*\*\*, në adresën Lulëzim, Tepelenë, në vlerën 500.000 lekë, e kryer jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje tokë bujqësore nr.\*\*\*, datë 25.04.2006, me palë shitëse Dilaver Alushi, Liri Alushi, R. A, E. A dhe Elton Alushi, të një sasi toke të përfutur nga Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për Tokën”, e regjistruar pasuria në emër të kryefamiljarit të familjes bujqësore Dilaver Alushi, të dy parcelave: parcela me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 2, 400 m<sup>2</sup> në Zonën Kadastrale \*\*\*, parcela me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 500 m<sup>2</sup>, në vlerën 500.000 lekë të dyja, në adresën Lulëzim Tepelenë.
- Kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\*, datë 26.02.2007, me palë shitëse Elton Alushi dhe Elsa Alushi dhe palë blerëse Q. A, të një toke arë me sip. 500 m<sup>2</sup> në adresën Prush, Tiranë, e regjistruar në Zonën Kadastrale \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në shumën 1.000.000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare të Elton Alushi, në monedhën lekë, ku rezultojnë veprimet, si më poshtë:

- Në datë 27.02.2007, është depozituar cash shuma 1.800.000 lekë.
- Në datë 19.06.2007, kalim midis llogarive të shumës 1.914.000 lekë, nga Dilaver Alushi.
- Në datë 19.06.2007, është tërhequr shuma 3.000.000 lekë.
- Në datë 14.08.2007, është tërhequr shuma 719.300 lekë.
- Në datë 04.04.2019, kredituar llogaria në vlerën 1.750.000 lekë, nga A. N, kalim fondi sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 03.04.2019.
- Në datë 06.07.2020, kredituar llogaria në vlerën 4.596.150 lekë, kalim fondi.

**Tirana Bank**, me postën elektronike të datës 19.12.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie bankare në emër të Elton Alushi, ku në datë 04.12.2007 është disbursuar kredia bankare në vlerën 22.000 euro dhe në datë 05.12.2007 është debituar vlera 21.654 euro, në llogari të “\*\*\* sh.p.k”, për pagesë blerje apartamenti. (Trajtuar më poshtë).

**OTP Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.08.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare të Elton Alushi, ku në datë 01.07.2020 është kredituar shuma 4.948.000 lekë nga A. K dhe A.N, pagesë përfundimtare sipas kontratës kalim të drejtash nr. \*\*\*, datë 03.04.2019. Më datë 03.07.2020, debitoheh nga llogaria shumat 350.000 lekë dhe 4.596.150 lekë. Llogaria rezulton e mbyllur.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjekti u pyet ne lidhje me burimin financiar për blerjen e apartamentit me sip. 110 m<sup>2</sup>, rr. “\*\*\*”, dokumentacionin e dorëzuar, si dhe shlyerjen e kredisë bankare në Tirana Bank.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti sqaroi se pagesat për blerjen e apartamentit tek firma e ndërtimit “\*\*\*” sh.p.k, janë kryer një pjesë cash dhe një pjesë me transfertë bankare nga kredia bankare.

Burimi financiar i pagesës së kështit të parë janë: Kursimet familjare te subjektit dhe bashkëshortes, në shumën rreth 800.000 lekë dhe shitja e tokës në fshatin Prush në shumën 1.000.000 lekë, të depozituara në shkurt 2007, pranë Raiffeisen Bank, në shumën 1.800.000 lekë. Transfera nga llogaria e babait Dilaver Alushi, në shumën 1.914.000 lekë, ka burim shitjen e një sipërfaqe toke dhe një banese në fshatin Lulëzim, në shumën 1.000.000 lekë, si dhe kursimet ndër vite nga puna dhe pensioni i babait si mjek dhe e nënës në shumën rreth 915.000 lekë. Subjekti sqaroi, se prindërit duke jetuar në fshat, prodhimet bujqësore i siguronin nga toka bujqësore.

Në datë 19.06.2007 është tërhequr shuma 3.000.000 lekë nga llogaria, e cila është konvertuar dhe është bërë pagesa e kështit të parë, sipas kontratës së porosisë. Mandat pagesën e parë kundrejt kësaj shoqërie nuk e disponon për shkak të kohës së largët dhe tjetërsimit të pronës.

Në datë 14.08.2007 është tërhequr nga llogaria në Raiffeisen Bank, shuma 719.300 lekë dhe pasi është konvertuar është bërë pagesa e mbetur. Për të plotësuar pagesën e fundit, subjektit, me sa i kujtohet, ka shtuar dhe ndonjë diferencë të vogël nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes. Referuar mandatpagesës është kryer pagesa në shumën 6.700 euro, në datë 14.08.2007.

Në datën 20.11.2007, sipas kontratës noteriale nr. \*\*\*, është bërë pagesa e pjesës së mbetur në shumën 22.000 euro, nëpërmjet kredisë së Bankës Tirana, në llogarinë bankare të shoqërisë “\*\*\* sh.p.k”.

Subjekti sqaroi se ka jetuar së bashku me prindërit në të njëjtën shtëpi, pasi prindërit shitën shtëpinë e tyre dhe jetuan me familjen e subjektit (me ekonomi të ndarë). Subjekti është strehuar në këtë pallat papërfunduar punimet e tij, për shkak se duhet të bashkohej e gjithë familja, (me sa i kujtohet, në fund të vitit, në dhjetor 2007). Subjekti shtoi se babai dhe nëna kanë jetuar në shtëpinë që shitën në fshatin Lulëzim, deri sa u strehuan në pallatin e ndërtuar nga shoqëria “\*\*\* sh.p.k”, kjo pasi shtëpinë prindërit i’a shitën një të afërmi, që ishte në emigrim në Greqi dhe nuk kishte nevoja të ngutshme për strehim.

Referuar kontratës së kalimit të të drejtave, subjekti ka deklaruar se ka përfituar shumën 7.200.000 lekë, nga shitja e apartamentit. Ai ka deklaruar shumën prej 6.700.000 lekë, për arsye të pagesave me bankë, që blerësi i banesës A. N i ka bërë dhe pjesën e mbetur prej 500.000 lekë, e

ka likuiduar pjesë - pjesë, e dhënë cash. Duke qenë se është individ, nuk ka mandat pagese për vlerën 500.000 lekë.

Shpenzimet e kryera për mobilim nga subjekti, kanë qenë në vlera minimale (për shkak dhe të mundësive ekonomike), duke futur këtu edhe elektroshtëpiake të përdorura edhe mobilje të marra nga banesa që prindërit kanë shitur në fshatin Lulëzim. **Paraqiti:**

- Kontratë kalim të drejtash nr. \*\*\*, datë 03.04.2019, me palë të parë Elton Alushi dhe Elsa Alishi, palë e dytë A. K dhe A. N dhe palë e tretë shoqëria ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. (përmendur më sipër).
- Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 19.06.2007, me sipërmarrës firma “\*\*\*\*” sh.p.k dhe porositës Elton Alushi, të apartamentit nr.\*\*\*, shkalla \*\*\*, 2+1, kati \*\*\*, me sip. 110 m<sup>2</sup>, (përmendur më sipër). Bashkëlidhur certifikatë provizore nr. \*\*\*, datë 19.07.2007, në emër të “\*\*\*\* sh.p.k”, të apartamentit 2+1, me sip. 110 m<sup>2</sup>, në Zonën Kadastrale \*\*\*, në adresën Yzberisht, Kashar. Bashkëlidhur praktika e ndërtuesit, planimetria dhe kopje të kartave të identitetit.
- Depozitim në llogari personale në Raiffeisen Bank datë 04.04.2019, në emër të A. N, të shumës 1.750.000 lekë, me burim kursime familjare.
- Mandat arkëtimi datë 14.08.2007, në favor të subjektit “\*\*\*\* sh.p.k” nga Elton Alushi, në shumën 6.700 euro, likuidim i pjesshëm i këstit të dytë.

Trupa e Vlerësimit ka konstatuar se subjekti i vlerësimit ka përfituar nga shitja e apartamentit, vlerën rreth 767.376 lekë, për të cilën është pyetur me emailin e datës 03.06.2024, lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore sa i përket fitimit që ka gjeneruar në total nga shitblerja e apartamentit.

Me emailin e datës 05.06.2024, subjekti i vlerësimit ka deklaruar se: “...Kjo pasuri në momentin e kalimit të të drejtave nga ana e tij dhe e bashkëshortes, shtetasve A. K dhe A. N, në vitin 2019, nuk ka qënë ende e regjistruar pranë zyrës përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtëshme, Tiranë, dhe për rrjedhojë nuk ka patur dokumentacion pronësie, për këtë qëllim shitja është kryer me kontratë kalim të drejtash si më sipër.

Shoqëria e ndërtimit “\*\*\*\* sh.p.k”, ka dhënë pëlqimin e saj dhe ka qënë në dijeni për vlerën e përcaktuar në kontratën e kalim të drejtash duke marrë përsipër edhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë dhe për procedurat në vijim (kontratë shitje përfundimtare, regjistrimin e pasurisë në hipotekë, etj..). E njëjta edhe për palën përfituese të apartamentit, të cilët kanë pranuar dhe kanë rënë dakord për çmimin përkatës, duke pranuar rrjedhimisht edhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë, deri në regjistrimin e pasurisë në hipotekë, mbi bazën e kontratave/dokumentacionit që do të përpilohen në vijim me shoqërinë dhe palën përfituese.

Ndodhur në këto kushte, si palë shitëse nuk kanë patur detyrim të paguajnë tatim për këtë pasuri, pasi tatimi lind dhe paguhet në momentin e regjistrimit të pasurisë pranë zyrave përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtëshme, në momentin e kryerjes së procedurave përkatëse të regjistrimit të saj. Ky detyrim nga momenti i nënshkrimit të kontratës së sipërcituar, i takon shoqërisë së ndërtimit dhe palës përfituese të kësaj pasurie, detyrim i cili do të paguhet në

momentin e regjistrimit të apartamentit në hipotekë, pasi subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë më të drejta posedimi mbi këtë pasuri.

Shoqëria e ndërtimit në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitblerjes, do të deklarojë çmimin e shitjes sipas kontratës së dytë të kalimit të të drejtave dhe tatimi mbi fitimin do të paguhet si diferencë e çmimit të shitjes (sipas kontratës së dytë), me koston e ndërtimit. Sikurse rezulton, detyrimin për pagesën e tatimit mbi fitimin e ka shoqëria ndërtuese. Në këtë kuptim, e ardhura tatohet vetëm një herë dhe është shoqëria e ndërtimit që do të paguajë detyrimin tatimor së bashku me porositësin.

Në përfundim, sqaron se nga ana e tij dhe e bashkëshortes, nuk kanë patur detyrim për pagesën e tatimit mbi të ardhurat, pasi ky është një detyrim tatimor për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuri të paluajtëshme, i cili paguhet nga palët e tjera të përcaktuar në kontratën e kalimit të të drejtave nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë 03.04.2019, të shoqërisë së ndërtimit dhe/ose palëve A. K dhe A. N, si palë përfituese e apartamentit. Ky është një detyrim i cili paguhet vetëm një herë në momentin e regjistrimit të pasurisë pranë hipotekës, dhe nuk mund të paguhet dy herë, edhe nga shoqëria edhe nga pala që ka transferuar të drejtat dhe detyrimet. Ky është detyrim që lind dhe paguhet në momentin e regjistrimit të pasurisë, apartamentit në fjalë, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtëshme...”.

*Trupa e Vlerësimit, pasi analizoi kuadrin ligjor përkatës, si dhe shpjegimet e subjektit të vlerësimit, konstaton se subjekti i vlerësimit ka gjeneruar të ardhura nga shitja e apartamentit në vlerën rreth 767.376 lekë (2019 – 2020), për të cilat duhet të paguante detyrimet tatimore sipas nenit 7, të Ligjit nr. 8438 datë, 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

*Sa më sipër, është marrë për bazë vlera e mbetur duke zbritur detyrimin tatimor sipas legjislacionit të periudhës përkatëse. Gjithashtu nuk është marrë për bazë vlera prej 500.000 lekë, përfituar cash nga subjekti i vlerësimit, i cili nuk e ka vërtetuar me dokumentacionin përkatës.*

### **Konkluzion:**

Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar nga Trupa e Vlerësimit, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- *Apartamenti me sip. 110 m<sup>2</sup>, në adresën Kashar, Tiranë, është blerë me kontratë porosie në korrik 2007, me çmim 52.800 euro, me burim kredi bankare në shumën 22.000 euro, shitje të pasurive të paluajtshme të subjektit dhe babait në shumën 2.000.000 lekë, kontribut i prindërve në shumën 915.000 lekë, si dhe kursimet familjare të subjektit.*
- *Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion në lidhje me apartamentin në Kashar, blerë në vitin 2007 në shumën 52.800 euro dhe shitur në vitin 2019 në shumën 7.200.000 lekë, si dhe burimin financiar për blerjen e tij (trajtuar në rubrikën e të ardhurave).*
- *Subjekti dha shpjegime lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore që lindin nga shitblerja e apartamentit, ku janë gjeneruar në total të ardhura në vlerën rreth 767.376 lekë, marrë në vlerësim nga Trupa e Vlerësimit.*
- *Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie.*



- *Lidhur me pasurinë e trajtuar, si dhe të ardhurat e përmendura nga subjekti si burim krijimi (kursime familjare, të ardhura nga shitblerjet e pasurive të krijuara përpara vitit 2008), ndodhemi në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.*
3. Kontratë noteriale shitje banese në Lulëzim Tepelenë. Vlera 500.000 lekë. **Bashkëlidhur deklaratës:**
- Kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 25.04.2006, me palë shitëse Dilaver Alushi, të një trualli me sip. 300 m<sup>2</sup>, mbi të cilën ngrihet një shtëpi banimi, me sip. 112.7 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, në Zonën Kadastrale \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në adresën Lulëzim, Tepelenë, në vlerën 500.000 lekë, e kryer jashtë zyrës noteriale.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Agjencia Shtetërore e Kadastrës**, nuk konfirmon pasuri të regjistruar, në emër të Elton Alushi.

**Agjencia Shtetërore e Kadastrës online**, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të Dilaver Alushi. **Paraqiti:**

- Certifikatë familjare të gjendjes familjare në vitin 1991, të familjes “Alushi”, e përberë me 5 anëtarë, në Njësinë Administrative, Krahës, Lulëzim, Tepelenë.

Me postën elektronike të datës 06.03.2024, subjekti u pyet në lidhje me origjinën e pasurisë së shitur në emër të babait.

Subjekti sqaroi se banesa në fshatin Lulëzim, Tepelenë, e shitur në vlerën 500.000 lekë është e ndërtuar nga shteti dhe privatizuar po nga shteti, në fillimet e viteve 1990 me vlerë minimale. Nuk disponon dokumente për shkak të kohës së gjatë dhe tjetërsimit të saj, nuk kanë pasur interes të ruajnë këto dokumente.

### **Konkluzion:**

- *Subjekti dha shpjegime në lidhje me origjinën e pronës së tjetërsuar, të përfitur nga privatizimi.*
- *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.*
- *Lidhur me pasurinë e trajtuar më sipër, ndodhemi në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.*

4. Kontratë shitje toke bujqësore në Lulëzim, Tepelenë të dy tokave arë me sipërfaqe 2, 400 m<sup>2</sup> dhe 500 m<sup>2</sup>, në vlerën 500.000 lekë. Burimi i krijimit: Përfitur nga Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për Token”. **Bashkëlidhur deklaratës:**
- Kontratë shitje toke bujqësore nr. \*\*\*, datë 25.04.2006, me palë shitëse Dilaver Alushi, Liri Alushi, R. A, E. A dhe Elton Alushi, të një sasi toke të përfitur nga Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për Token”, e regjistruar pasuria në emër të kryefamiljarit të familjes bujqësore Dilaver Alushi, të dy parcelave përmendur më sipër.
  - Certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë nr. \*\*\*, në emër të Dilaver Alushi, të pasurisë së llojit arë me sip. 1, 200 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, në Zonën Kadastrale \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në Lulëzim, Tepelenë, e regjistruar në datë 21.03.2008.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Agjencia Shtetërore e Kadastrës,** nuk konfirmon pasuri të regjistruar, në emër të Elton Alushi.

**Agjencia Shtetërore e Kadastrës online,** nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të Dilaver Alushi.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjektit i'u kërkuan shpjegime në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024 subjekti ka dorëzuar certifikatën e pronësisë në emër të babait për pasurinë e llojit arë, me sip. 1, 200 m<sup>2</sup>, ku zotëron 1/5 pjesë të saj. Nuk e ka pasqyruar atë, pasi nuk janë kryer procedurat për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë ligjore. Prona ndodhet në emër të kryefamiljarit.

Subjekti ka sqaruar se referuar AMTP dhe certifikatës së gjendjes civile në vitin 1991, sqaroi se zotëron sipërfaqen prej 1/5 tokë bujqësore përpara shitjes dhe pas shitjes së një pjese të saj. Këto toka, në të gjithë këto vite janë menaxhuar nga subjekti (sipas mundësive), së bashku me prindërit, në mbjelljen e prodhimeve bujqësore, duke përfitur ullinj, rrush dhe perime të ndryshme. Nuk ka kryer investime të rëndësishme, por vetëm mbjelljen e produkteve bujqësore. Pjesa e ullinjve dhe e vreshtave kanë qenë të mbjella me parë. **Paraqiti:**

- Certifikatë familjare të gjendjes familjare në vitin 1991, të familjes “Alushi”, e përberë me 5 anëtarë.
- Akti i marrjes së tokës në pronësi, në emër të Dilaver Alushi, i cili ka përfitur tokë bujqësore me sip. 4, 100 m<sup>2</sup>.

### **Konkluzion:**

- *Subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar shitjen e sip. 2, 900 m<sup>2</sup> tokë në Lulëzim, Tepelenë, nga 4, 100 m<sup>2</sup> e përfitur nga Ligji nr. 7501. Pjesa e mbetur prej 1, 200 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, figuron e regjistruar në emër të kryefamiljarit Dilaver Alushi.*

- *Agjencia Shtetërore e Kadastrës, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit dhe të babait të tij.*
  - *Lidhur me pasurinë e trajtuar më sipër, ndodhemi në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.*
5. Kontratë shitje e një toke arë, në fshatin Prush, Tiranë, për shumën 1.000.000 lekë.
  6. Kontratë blerje e një sipërfaqe toke në fshatin Prush, Tiranë, me vlerë 200.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat familjare.

#### **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr.\*\*\*, datë 26.02.2007, me palë shitëse Elton Alushi dhe Elsa Alushi dhe palë blerëse Q. A, të një toke arë me sip. 500 m<sup>2</sup>, në adresën Prush, Tiranë, e regjistruar në Zonën Kadastrale \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në shumën 1.000.000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\*, datë 13.03.2006, me palë shitëse E. H, L. H dhe me palë blerëse Elton Alushi, të një toke arë, me sip. 500 m<sup>2</sup>, në adresën Prush, Tiranë, e regjistruar në Zonën Kadastrale \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në shumën 200.000 lekë, e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

#### **Procedura e vlerësimit:**

**Agjencia Shtetërore e Kadastrës,** nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të Elton Alushi.

*Trupa e Vlerësimit, konstaton se subjekti i vlerësimit në vitin 2007, ka gjeneruar të ardhura nga shitja e asetit të mësipërm në vlerën rreth 800.000 lekë, për të cilat duhet të paguante detyrimet tatimore sipas nenit 7, të Ligjit nr. 8438 datë, 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar).*

*Pavarësisht konstatimit të mësipërm, për pasurinë objekt vlerësimi ndodhemi në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.*

#### **Konkluzion:**

- *Toka arë me sip. 500 m<sup>2</sup>, në adresën Prush, Tiranë, është blerë në datë 13.03.2006, në shumën 200.000 lekë dhe shitur në shkurt 2007, në shumën 1.000.000 lekë.*
- *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur nga subjekti.*
- *Agjencia Shtetërore e Kadastrës, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit.*
- *Lidhur me pasurinë e trajtuar më sipër, nuk administrohet dokumentacion lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me të ardhurat nga shitja e asetit, por ndodhemi në*

*kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.*

7. Autoveturë tip Mercedes Benz, viti i prodhimit 2007, me targa AA \*\*\* MR, blerë në 23.09.2015, në vlerën 4.000 euro. Burimi i krijimit: Të ardhura nga shitja e mëparshme e mjetit me targë AA \*\*\* KM, me vlerë 6.700 euro. **Bashkëlidhur deklaratës:**
  - Kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. \*\*\*, datë 23.09.2015, me palë blerëse Elton Alushi, të mjetit tip Daimler Chrysler, e vitit 2007, me targë AA \*\*\* IN, në vlerën 4.000 euro.
  - Kontratë shitje pasuri e luajtshme, nr. \*\*\*, datë 14.09.2015, me palë shitëse Elton Alushi, të mjetit tip Mercedes Benz, i vitit 2004, me targë AA \*\*\* KM, në vlerën 6.700 euro.

### **Procedura e vlerësimit:**

**DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\*, datë 18.08.2023, konfirmon se Elton Alushi, ka pasur të regjistruar mjetin me targë AA \*\*\* MR. Bashkëlidhur praktika e mjetit, konkretisht:

- Kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. \*\*\*, datë 04.07.2023, me palë shitëse Elton Alushi, të mjetit tip Daimler Chrysler, me targë AA \*\*\* MR, me shasi nr. WDB\*\*\*60681, në vlerën 3.500 euro.
- Kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. \*\*\*, datë 23.09.2015, me palë blerëse Elton Alushi të mjetit tip Daimler Chrysler, e vitit 2007, me shasi nr. WDB\*\*\*60681, me targë AA \*\*\* IN, në vlerën 4.000 euro.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjekti u pyet për burimin financiar për blerjen e mjetit.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti sqaroi se në datën 23.09.2015, ka blerë mjetin me targë AA \*\*\* IN, në vlerën 4.000 euro, me burim financiar shitjen e mjetit me targë AA \*\*\* KM. Subjekti sqaroi se mjeti tip Mercedes Benz është i njëjti mjet, por që është bërë ndryshimi i targave nga AA \*\*\* IN, në AA \*\*\* MR.

### **Konkluzion:**

- ***Automjeti tip Mercedes Benz, me targë AA \*\*\* IN, është blerë në datë 23.09.2015, me burim financiar nga shitja e mjetit me targë AA \*\*\* KM, në datë 14.09.2015.***
  - ***Nga DPSHTRR konfirmohet shitja e automjetit Mercedes Benz, pas datës së dorëzimit të deklaratës.***
8. Kontratë blerje automjeti Mercedes Benz, viti i prodhimit 2002, me targë AA \*\*\* GL, e datës 16.07.2013, në vlerën 550.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat familjare dhe 355.000 lekë të dhëna nga Dilaver Alushi.
  9. Kontratë shitje automjeti e datës 25.02.2015, me targë AA \*\*\* GL, në vlerën 5.000 euro. **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë datë 16.07.2013, me palë shitëse F. Sh dhe palë blerëse Elton Alushi të mjetit tip Daimler Chrysler, i vitit 2002, me targë AA \*\*\* GL, në vlerën 550.000 lekë.
- Kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*, datë 25.02.2015, me palë shitëse Elton Alushi dhe palë blerëse B. V, të mjetit tip Daimler Chrysler, i vitit 2002, me targë AA \*\*\* GL, në vlerën 5.000 euro.

### **Procedura e vlerësimit:**

**DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.08.2023, konfirmon se Elton Alushi, ka pasur të regjistruar mjetin me targë AA \*\*\* MM (AA \*\*\* GL). Bashkëlidhur dosja e mjetit, konkretisht kontratat respektive që ka dorëzuar subjekti i vlerësimit.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjektit i'u kërkua të sqarojë burimin financiar për blerjen e mjetit dhe vlerën e shitjes së tij.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti ka sqaruar se mjetin e parë me targë AA \*\*\* GL, e ka blerë në datën 16.07.2013, me burim ndihmë nga babai në shumën 355.000 lekë, shumë e tërhequr nga llogaria e tij në Raiffeisen Bank, ndërsa pjesa e mbetur është paguar nga kursimet e tij. Ky mjet më vonë është shitur për shumën 5.000 euro sipas deklaratës noteriale në datën 25.02.2015. Në lidhje me vlerën e blerjes së mjetit me targë AA \*\*\* MM (AA \*\*\* GL), në shumën 550, 000 lekë dhe shitje në shumën 5.000 euro, subjekti sqaroi se makina ka qenë në kushte teknike të mira, i janë kryer shërbime, prandaj është shitur pas dy vitesh në shumën 5.000 euro. **Paraqiti:**

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të Dilaver Alushi, ku në datën 15.07.2013 është tërhequr cash shuma 355.000 lekë.

Me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave financiare si dhe vlerësimin e mundësisë për kursimin e vlerës prej 550.000 lekë, më datë 16.07.2013, Trupa e Vlerësimit analizoi të dhënat financiare përkatëse.

### **Konkluzion:**

- ***Automjeti Mercedes Benz me targë AA \*\*\* GL, është blerë me kontratë në datë 16.07.2013, në shumën 550, 000 lekë dhe tjetërsuar me kontratë në datë 25.02.2015, në vlerën 5.000 euro.***
- ***DPSHTRR konfirmon blerjen dhe shitjen e mjetit Mercedes Benz, me targë AA \*\*\* GL.***
- ***Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme me qëllim blerjen e automjetit në vitin 2013.***

**10.** Kontratë blerje automjeti Mercedes Benz me targë AA \*\*\* KM, e datës 25.02.2015, në vlerën 3.000 euro. Burimi i krijimit: Nga shitja e automjetit të mëparshëm AA \*\*\* GL. **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*, datë 25.02.2015, me palë shitëse A. R dhe palë blerëse Elton Alushi, të mjetit tip Mercedes Benz, e vitit 2004, me targë AA \*\*\* KM, në vlerën 3.000 euro.

- Kontratë shitje pasuri e luajtshme nr. \*\*\*, datë 14.09.2015, me palë shitëse Elton Alushi, të mjetit tip Mercedes Benz, i vitit 2004, me targë AA \*\*\* KM, në vlerën 6.700 euro.
- Kontratë shitje automjeti nr. \*\*\*, datë 25.02.2015, me palë shitëse Elton Alushi dhe palë blerëse B. V, të mjetit tip Daimler Chrysler, i vitit 2002, me targë AA \*\*\* GL, në vlerën 5.000 euro.

### **Procedura e vlerësimit:**

**DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.08.2023, konfirmon se Elton Alushi, ka pasur të regjistruar mjetin me targë AA \*\*\* NL (AA \*\*\* KM). Bashkëlidhur dosja e mjetit, konkretisht kontratat respektive të dorëzuara nga subjekti i vlerësimit.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjektit i'u kërkua të sqarojë burimin financiar për blerjen e mjetit, vlerën e blerjes dhe të shitjes.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti ka sqaruar se referuar deklaratës noteriale në datën 25.02.2015, ai ka blerë mjetin tip Mercedes Benz, me targë AA \*\*\* KM, në shumën okazion 3.000 euro, me burim shitjen e mjetit me targë AA \*\*\* GL. Ky mjet është shitur brenda pak muajve, pasi personi të cilit i'a shiti atë, i ofroi një vlerë të lartë, të cilën e finalizoi në datën 14.09.2015, për shumën 6.700 euro.

Me emailin e datës 02.05.2024, subjekti i vlerësimit është pyetur nëse është paguar tatimi mbi të ardhurat nga shitja e automjetit me targë AA \*\*\* KM (vlera 3.700 euro), sipas nenit 8, germa g, të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Me emailin e datës 09.05.2024, subjekti i vlerësimit ka deklaruar se nuk ka pasur dijeni për detyrimin për të paguar tatim fitimin. Pasi është njohur me këtë fakt ka paguar tatimin në burim për të cilën ka paraqitur dokumentacion. Vlera e paguar është në shumën 77.700 lekë.

Në momentin kur ka nënshkruar kontratat pranë noterit, nga ana e noterit nuk është venë në dijeni pagesa e tatimit në burim për pasuri të luajtshme (automjet). **Paraqiti:**

- Njoftim debitimi në Raiffeisen Bank datë 03.05.2024, të vlerës 77.700 lekë, me përfitues Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, me përshkrimin "*Tatimi mbi të ardhurat individuale janar – dhjetor 2015*".
- Urdhër pagesë datë 03.05.2024, në vlerën 77, 700 lekë, me përshkrimin "*DIVA, deklaram individual për 15-A, periudha tatimore janar – dhjetor 2015*".

### **Konkluzion:**

- ***Autovetura Mercedes Benz, me targë AA \*\*\* KM, është blerë me kontratë blerje datë 25.02.2015 dhe tjetërsuar me kontratë shitje, datë 14.09.2015. Si burim financiar për blerjen e mjetit kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e mjetit me targë AA \*\*\* GL, në datë 25.02.2015.***

- *DPSHTRR konfirmon veprimet e kryera për shitblerjen e mjetit Mercedes Benz, me targë AA \*\*\* KM në periudhën shkurt - shtator 2015, për të cilin subjekti paraqiti dokumentacionin përkatës.*
- *Subjekti dha shpjegime në lidhje me burimin financiar të blerjes dhe vlerën e shitjes së pasurisë së luajtshme.*
- *Subjekti i vlerësimit paraqiti dokumentacion lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga shitja e automjetit.*

11. Blerë makinë BMW 318 ngjyrë blu, në vitin 2005, me një shumë të përafërt 260.000 lekë dhe shitur në vitin 2006, për një shumë të përafërt 320.000 lekë.

### **Procedura e vlerësimit:**

**DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.08.2023, nuk konfirmon mjet të regjistruar në emër të Elton Alushi.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjektit i'u kërkua të paraqesë dokumentacion dhe të sqarojë burimin financiar për blerjen e mjetit.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, në lidhje me mjetin BMW 318, të blerë në vitin 2005, subjekti ka sqaruar, se nuk ka nënshkruar kontratë blerje dhe shitje, por e ka deklaruar për transparencë pronësinë e këtij mjeti. Nuk disponon dokument dhe nuk kujton targën e as numrin e shasisë.

Mjetin e ka përdorur për rreth 10 muaj, blerë në korrik 2005, në një shumë të përafërt 260.000 lekë dhe shitur në prill 2006, me sa i kujtohet për një shumë të përafërt 320.000 lekë. Burimi financiar kanë qenë kursimet familjare.

Me emailin e datës 09.05.2024, subjekti i vlerësimit është shprehur se mjetin e ka deklaruar për transparencë, nuk ka as dokument dhe nuk kujton targën e plotë dhe as numrin e shasisë. Mjetin e ka marrë nga familjarët e pronarit i cili ndodhet jashtë shtetit dhe për këtë arsye nuk ka nënshkruar akt noterial. Në momentin që ka gjetur një blerës, me sa i kujtohet nga Berati, shitja e mjetit është kryer nga pronari i cili kishte ardhur nga jashtë, në vlerën e përafërt të deklaruar rreth 320.000 lekë.

Ka kaluar një kohë e gjatë gati 18 vite dhe me sa i kujtohet targat kanë qenë të qytetit të Tiranës, e targuar me targa shqiptare. Shton se me pronarin dhe të afërmit e tyre nuk ka as lidhje dhe as kontakt.

### **Konkluzion:**

- *Mjeti është deklaruar i blerë në korrik 2005, në shumën 260.000 lekë dhe shitur në prill 2006, në vlerën 320.000 lekë.*
- *DPSHTRR nuk konfirmon mjet të tipit BMW, në emër të Elton Alushi, për të cilin subjekti ka dhënë shpjegime, pa paraqitur dokumentacion justifikues ligjor.*

- *Të ardhurat e gjeneruara nga shitja e automjetit të mësipërm nuk janë marrë në konsideratë dhe nuk janë përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie tjetër.*
- *Lidhur me pasurinë e trajtuar më sipër, ndodhemi në kushtet e nenit 32, pika 1.1, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.*

12. Llogari bankare rrjedhëse e pagave Raiffeisen Bank, me gjendje deri në 05.03.2023, vlera 234.264 lekë.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon se Elton Alushi ka llogari page, me balancë në datën 09.03.2023 në vlerën 334.680 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezultoi se *nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.*

13. Llogari bankare depozitë në euro në Raiffeisen Bank, e krijuar nga pagat dhe shitja e apartamentit të mëparshëm. Vlera 21.311 euro.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon se Elton Alushi ka llogari rrjedhëse me balancë në datën 09.03.2023, në vlerën 21.311 euro. Bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare në monedhën lekë dhe euro.

#### Monedha lekë:

- Në datë 06.07.2020, kredituar llogaria nga transferta në vlerën 4.596.150 lekë, kalim fondi.
- Në datë 08.07.2020, debituar llogaria në vlerën 5.900.050 lekë, kalim për këmbim.
- Në datë 23.07.2020, kredituar llogaria në vlerën 1.172.500 lekë, nga Elsa Alushi.
- Në datë 10.08.2022, debituar llogaria në vlerën 1.020.050 lekë, kalim për këmbim.

#### Monedha euro:

- Në datë 10.12.2007, Elton Alushi derdh në llogari 5.000 euro.
- Në datë 22.12.2008, Elton Alushi tërheq nga llogaria 2.000 euro.
- Në datë 28.01.2009, Elton Alushi tërheq nga llogaria 1.000 euro.
- Në datë 29.01.2009, Elton Alushi tërheq nga llogaria 2.100 euro.
- Në datë 20.08.2018, Admir Filaj derdh në llogari 5.945 euro.



- Në datë 22.08.2018, Elton Alushi debiton nga llogaria 7.398 euro, kalim kësti për blerje apartamenti.
- Në datë 22.08.2018, Elton Alushi derdh në llogari 1.450 euro.
- Në datë 08.07.2020, kredituar shuma 47.504 euro, me kurs 124.2 lekë.
- Në datë 21.10.2020, Elton Alushi tërheq nga llogaria 20.000 euro.
- Në datë 01.07.2021, debituar shuma 5.000 euro, kalim kësti për blerje apartamenti.
- Në datë 05.04.2022, Elton Alushi, tërheq nga llogaria 10.000 euro.
- Në datë 10.08.2022, kredituar shuma 8.732 euro, me kurs 116.8 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.***

**Referuar analizimit të të dhënave financiare, rezulton se subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme me qëllim kursimin e vlerës prej 21.311 euro në datë 09.03.2023**

14. Llogari bankare depozitë në dollar në Raiffeisen Bank. Vlera 0 usd.

#### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon se Elton Alushi ka llogari rrjedhëse me balancë në datën 09.03.2023, në vlerën 0.36 usd. Bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare në monedhën usd.

#### **Monedha usd:**

- Në datë 20.08.2018, A. F derdh në llogari 14.914 usd.
- Në datë 22.08.2018, Elton Alushi debiton shumën 14.914 usd, kalim kësti për blerje apartamenti.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.***

#### **Deklarimi i të ardhurave financiare ndër vite të subjektit të vlerësimit**

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/b, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron të ardhurat nga paga, nga angazhime në veprimtari private dhe/ose publike, me qëllim fitimi dhe çdo lloj veprimtarie të kryer brenda dhe jashtë vendit, që ka krijuar të ardhura,

si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, licenca dhe patenta, që sjellin fitim, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe pjesëmarrje në çdo organizatë

tjetër të subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur me të për periudhën nga momenti i fillimit të detyrës deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë.

Sa më sipër subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

- ❖ Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit, nga viti 2000 deri në vitin 2023, në vlerën 16.359.000 lekë.
  - ❖ Të ardhurat nga pensioni i Liri Alushi, (pjesë përbërëse e certifikatës familjare deri në muajin shkurt 2015). Periudha 2003 - 2015, vlera 3.300.000 lekë.
  - ❖ Të ardhura si ndihmës mjekë e Liri Alushi, (pjesë përbërëse e certifikatës personale deri në muajin shkurt 2015), për periudhën 2000 - 2003, vlera 900.000 lekë.
  - ❖ Të ardhura nga paga e Dilaver Alushi, (pjesë përbërëse e certifikatës personale deri në muajin shkurt 2015), si mjek, për periudhën 2000 - 02.08.2010, vlera 5.632.000 lekë.
  - ❖ Të ardhurat nga pensioni i pleqërisë së babait tim, periudha 2010 – 2015, (pjesë përbërëse e certifikatës familjare deri në muajin shkurt 2015), vlera 2.100.000 lekë.
  - ❖ Të ardhurat nga trajtimi si invalid i Dilaver Alushi, (pjesë përbërëse e certifikatës familjare deri në muajin shkurt 2015), vlera 480.000 lekë. **Bashkëlidhur deklaratës:**
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, që konfirmon se Elton Alushi, ka përfituar pagën neto për periudhën 11.09.2000 - 01.06.2004, në shumën 1.087.422 lekë.
  - Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 01.03.2018, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, që konfirmon se Elton Alushi, ka përfituar pagën neto për periudhën 01.06.2004 - 21.10.2013. Të ardhurat nga paga për periudhën 01.06.2004 - 31.12.2005, janë në shumën 952.500 lekë.
  - Vërtetim nr. \*\*\*, datë 22.02.2018, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që konfirmon se Liria Alushi, përfiton pension pleqërie në masën 27.596 lekë, (llogaritur për periudhën shkurt 2018 - prill 2019, në shumën 386.344 lekë). Bashkëlidhur kopje të kartave të identitetit dhe pasaportë.
  - Vërtetim nga Bashkia Tiranë, që vërteton se shtetasi Dilaver Alushi, trajtohet si invalid me masë 11.730 lekë në muaj, nga data 23.02.2018, (llogaritur për periudhën shkurt 2018 - prill 2019, në shumën 164.220 lekë).
  - Vërtetim nr. \*\*\*, datë 22.02.2018, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që konfirmon se Dilaver Alushi, përfiton pension pleqërie në masën 39.928 lekë, (llogaritur për periudhën shkurt 2018 - prill 2019, në shumën 558.992 lekë).
  - Certifikatë familjare në datë 19.02.2015, me 6 anëtarë, konkretisht: Dilaver Alushi, Liri Alushi, Elton Alushi, Elsa Alushi, Altonel Alushi dhe Ermela Alushi. Bashkëlidhur kopje të kartave të identitetit dhe pasaportë.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie bankare të Elton Alushi. Gjatë periudhës 01.01.2006 - 09.03.2023, janë kredituar pagat në vlerën rreth 14.874.855 lekë.

**Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2023, konfirmon si më poshtë për shtetasit:

- Elton Alushi ka përfituar të ardhura nga punësimi pranë “Drejtoria e Policisë Qarku Lezhë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë”, për periudhën janar 2012 - qershor 2023.
- Dilaver Alushi ka përfituar pension pleqërie me masë mujore përfundimtare nga muaji maj 2019 - tetor 2021, në vlerën 44.277 lekë, (llogaritur rreth 1.327.710 lekë).
- Liri Alushi përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale nga muaji maj 2019, në vlerën 36.238 lekë, (llogaritur rreth 1.703.186 lekë).

**Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.01.2024, ka bashkëlidhur:

- Vërtetim për vjetërsi në punë për efekt pensioni, nga Arkiva Qendrore e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që konfirmon se Liri Hoxhaj ka qenë në marrëdhënie pune në sektorë të ndryshëm.
- Vërtetim për vjetërsi në punë për efekt pensioni, nga Arkiva Qendrore e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që konfirmon se Dilaver Alushi, ka qenë në marrëdhënie pune në sektorë të ndryshëm.

**Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, i kërkon Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, që të dërgohet informacion pranë ILDKPKI, për periudhën para vitit 2012, për Elton Alushi dhe personat e lidhur me të.

**Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 23.08.2023, nr. \*\*\*, datë 03.01.2024, përcjell shkresën e Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, e cila informon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë-pagesave, për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet shtetërorë, juridikë apo fizikë, nuk mund të konfirmohet periudhë kontributesh apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepet emërtimi i qendrës së punës. Bashkëlidhur nipti i subjektit, fotokopje e librezës së punës, si dhe vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 15.08.2023, ku për shtetasin Elton Alushi nuk ka të dhëna për punësimin e tij.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjektit i'u kërkua të paraqesë dokumentacion në lidhje me të ardhurat para vitit 2005 dhe dokumentacion për të ardhurat e prindërve.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti sqaroi se ka filluar detyrën në shtator vitin 2000, ka përfituar dhe taksë solidariteti për rreth tre vjet, deri në dhjetor të vitit 2003. Për shkak të kohës së largët, nuk disponon dokument në lidhje me pagesën e taksës së solidaritetit, por sqaron se shumica mujore e përfituar është rreth 12.000 lekë në muaj, llogaritur vlera rreth 468.000 lekë.

Në lidhje me të ardhurat e deklaruara për prindërit, subjekti paraqiti dokumentacionin që ka mundur të sigurojë. Sqaron se nëna ka dalë në pension në vitin 2003 dhe babai ka dalë në pension në mars 1997, por më pas për shkak se kishte mungesa të mjekëve të zonës, babai i subjektit ka qenë në marrëdhënie pune. Përfundimisht ka dalë në pension në muajin gusht 2010. **Paraqiti:**

- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, që konfirmon të ardhurat nga pagat neto në emër të Elton Alushi, për periudhën 11.09.2000 - 01.06.2004, në vlerën 1.087.422 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, që konfirmon të ardhurat nga pagat neto në emër të Elton Alushi, për periudhën qershor 2004 - 31.12.2007.
- Vërtetim nr.\*\*\* prot., datë 28.12.2023, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që vërteton se Dilaver Alushi ka përfituar pension pleqërie deri në muajin tetor 2021, në masën 44.227 lekë/muaj, muaj në të cilin ka ndërruar jetë. Ka përfituar të ardhura nga pensioni, për periudhën 01.03.1997 - 31.07.1998, në shumën 72.351 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, në emër të Dilaver Alushi, që ka përfituar të ardhura nga punësimi për periudhën 01.01.1994 - 31.12.2005 në shumën 3.734.456 lekë.
- Nxjerrje llogari page në Raiffeisen Bank, në emër të Dilaver Alushi, ku i kreditohet paga për periudhën 01.01.2006 - 02.08.2010, në shumën 2.683.318 lekë.
- Vërtetim nr.\*\*\* prot., datë 27.12.2023, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që vërteton se Liri Alushi ka përfituar pension pleqërie në masën 36.238 lekë/muaj. Ka përfituar të ardhura nga pensioni për periudhën 02.05.2003 - 31.12.2005, në shumën 495.507 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare në emër të Liri Alushi që ka përfituar të ardhura nga punësimi për periudhën janar 1994 - 30.04.2003, në shumën 1.195.457 lekë.

### **Konkluzion:**

- **Të ardhurat neto të subjektit nga pagat, honorarët, shpërblimet, për periudhën shtator 2000 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 17.383.000 lekë, (përfshirë taksën e solidaritetit, për të cilën subjekti ka dhënë shpjegime).**
- **Të ardhurat nga pagat, pensioni i prindërve të subjektit, për periudhën janar 1994 - 2010, të konfirmuara nga dokumentacioni i paraqitur, janë në shumën rreth 10.232.000 lekë.**
- **Për periudhën 2010 - 2018, nuk ka informacion në lidhje me pensionet e prindërve.**
- **Të ardhurat nga pagat dhe pensioni i prindërve të subjektit, për periudhën 2018 - 2023, të konfirmuara nga dokumentacioni i paraqitur dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, janë në shumën rreth 4.093.000 lekë.**

### **Deklarimi i detyrimeve financiare të subjektit të vlerësimit**

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/c, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim ndaj të tretëve, etj.), që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer deri në datën e dorëzimit të formularit të deklaratës së pasurisë.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar detyrimet financiare si më poshtë:

1. Kredi bankare në Tirana Bank, për blerjen apartamenti marrë në 20.11.2007 dhe likuiduar totalisht në 17.11.2015. Likuiduar. **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë kredi bankare për blerje shtëpie nr. \*\*\*, datë 20.11.2007, nga Tirana Bank, me palë kredi marrëse Elton Alushi dhe Elsa Alushi, të shumës 22.000 euro, me afat 20 vjet, me qëllim blerjen e një apartamenti. Kredia do të sigurohet mbi vërtetimin për certifikatë provizore regjistrim hipoteke nr. \*\*\*, datë 19.07.2007, në Zonën Kadastrale \*\*\*, me sip.110 m<sup>2</sup>, godinë në Yzberisht, Kashar, në emër të firmës “\*\*\* sh.p.k”.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon se Elton Alushi ka pasur llogari në monedhën euro, aktive për periudhën 2007 - 2018, ka pasur kredi bankare në vitin 2007 dhe shtetasja Elsa Alushi është bashkë kredi marrëse në kredinë e marrë nga Elton Alushi. Bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare, ku konstatohen veprimet bankare:

- ✓ Në datë 09.10.2008, shlyer kësti 4.117 euro.
- ✓ Në datë 06.10.2009, shlyer kësti 2.200 euro.
- ✓ Në datë 17.11.2014, është shlyer kësti i fundit i kredisë bankare rreth 9.640 euro.
- ✓ Në datë 17.11.2015, është shlyer kësti i fundit i kredisë bankare rreth 1.600 euro.
- ✓ Ky shtetas është i lidhur me subjektin “\*\*\* sh.p.k”, me NIPT K47\*\*\*203F.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjekti u pyet në lidhje me konfirmimin në Tirana Bank dhe burimin financiar për shlyerjen e parakohshme të kredisë bankare në Tirana Bank.

Në proces verbalin e datës 16.02.2024, subjekti sqaroi se pagesa e parakohshme e kredisë në Tirana Bank është bërë nga kursimet nga pagat e tij dhe bashkëshortes, ku është bërë dhe pagesa e këstit më të madh në vlerën rreth 9.640 euro. Në lidhje me konstatimin e Tirana Bank, sqaroi se pagesa e fundit e shlyerjes së kredisë është bërë në datë 17.11.2015, në vlerën 1.600 euro, nga kursimet familjare në llogaritë rrjedhëse të tij dhe të bashkëshortes prej pagave. Kjo llogari ka vazhduar të funksionojë deri në vitin 2018, në vlera shumë të vogla (komisione bankare).

Në lidhje me konstatimin e Tirana Bank, subjekti sqaroi se nuk ka asnjë lloj marrëdhënie me subjektin “\*\*\* sh.p.k”. **Paraqiti:**

- Nxjerrje llogarie bankare në Tirana Bank, në emër të Elton Alushi, ku konfirmohen pagesat e kësteve të kredisë, sipas periudhave respektive si dhe shuma 1.600 euro, në datë 15.11.2015, me përshkrimin likuidim total të kredisë bankare.

### **Konkluzion:**

- **Subjekti dha shpjegime në lidhje me pagesën e parakohshme të kredisë bankare në Tirana Bank, me burim financiar kursimet familjare të tij dhe të bashkëshortes.**
- **Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë pasur të ardhura të mjaftueshme me qëllim pagesën e kësteve të kredisë.**

2. Kartë krediti tek Raiffeisen Bank me vlerë 500 euro. Të pa tërhequra.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon se Elton Alushi ka mastercard në monedhën euro, me detyrim financiar në datën 09.03.2023, në vlerën 0 euro. Bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare, limiti i kartës është në shumën 500 euro.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk linden dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.***

3. Kartë krediti tek Raiffeisen Bank, me vlerë 50.000 lekë. Të pa tërhequra.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon se Elton Alushi ka mastercard në monedhën lekë, me detyrim financiar në datën 09.03.2023, në vlerën 0 lekë. Bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare, limiti i kartës është në shumën 50.000 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk linden dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare të subjektit. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.***

4. Kredi bankare Raiffeisen Bank 800.000 lekë, lidhur në 2018, likuiduar në 04.04.2019.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon se Elton Alushi ka pasur kredi bankare në vitin 2018, disbursuar në shumën 800.000 lekë. Bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare, ku konstatohen veprimet bankare:

- Në datë 05.12.2018, pagesë principal kredie në vlerën 12.589 lekë;
- Në datë 07.01.2019, pagesë principal kredie në vlerën 14.879 lekë;
- Në datë 05.02.2019, pagesë principal kredie në vlerën 14.953 lekë;
- Në datë 05.03.2019, pagesë principal kredie në vlerën 15.026 lekë;
- Në datë 04.04.2019, pagesë principal kredie në vlerën 742.551 lekë.

**Kredia bankare në Raiffeisen Bank, është trajtuar më sipër, pasi është përdorur me qëllim shpenzimin për mobilimin e apartamentit të subjektit të vlerësimit në adresën, rr. “\*\*\*”, “Kompleksi \*\*\*”, Tiranë.**

5. Kontratë huaje nr. rep., \*\*\* dhe nr.kol., \*\*\*, datë 20.08.2018, për shumën 950.000 lekë nga B. C, nëpërmjet Raiffeisen Bank, me afat shlyerje deri në 20.08.2025, për blerjen e një apartamenti. Kthyer detyrimi me Raiffeisen Bank, në datë 04.04.2022. Likuiduar.  
**Bashkëlidhur deklaratës:**

- Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 20.08.2018, me deklarues B. C dhe Elton Alushi, ku Elton Alushi deklaroi se në datë 20.08.2018, do të marrë borxh nga deklaruesi B. C, vlerën prej 950.000 lekë, jashtë zyrës noteriale, me të drejtë kthimi në datë 20.08.2025, me qëllim blerjen e një pasurie të paluajtshme e llojit apartament në Tiranë. Vlera do të kalojë nëpërmjet llogarisë bankare pranë Raiffeisen Bank, nga z. B. C.
- Njoftim Debitimi, datë 04.04.2022, me urdhërues Elton Alushi, për shumën 950.000 lekë, kthim detyrimi sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 20.08.2018, me përfitues B. C.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie bankare të Elton Alushi, në monedhën lekë, ku rezultojnë veprimet, si më poshtë:

- Në datë 20.08.2018, kredituar llogaria në vlerën 950.000 lekë, nga B. C, me përshkrimin “dhënie borxh për blerje shtëpie”.
- Në datë 04.04.2019, kredituar llogaria në vlerën 1.750.000 lekë, nga A. N.
- Në datë 04.04.2022, debituar llogaria në vlerën 950.050 lekë përfitues B. C, përshkrimi “kthim detyrimi sipas kontratës nr.\*\*\*, datë 20.08.2018”.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjektit i’u kërkua dokumentacion ne lidhje me burimin financiar të huadhënësit, dhe shpjegime për burimin për shlyerjen e saj.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti sqaroi se burimi financiar për huadhënësin B. C, janë të ardhurat nga pagat e tij duke ju referuar llogarisë bankare. Shtetasi B. C nuk ka kryer investime të tjera gjatë periudhës 2008 – 20.08.2018.

Subjekti sqaroi se burimi financiar për shlyerjen e këtij borxhi nga subjekti, janë të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 2019. Veprimi është kryer me bankë në datë 04.04.2022, në vlerën 950.050 lekë, përfitues B. C, përshkrimi “kthim detyrimi sipas kontratës nr.\*\*\*, datë 20.08.2018”.

### **Paraqiti:**

- Nxjerrje llogari bankare pranë Raiffeisen Bank, në emër të B. C, për periudhën 29.03.2013 - 26.12.2023, ku nga verifikimi rezultoi se në datën 20.08.2018, ka depozituar cash shumën 950.000 lekë, të cilën e ka transferuar dhënie borxhi, sipas kontratës noteriale për blerje shtëpie për Elton Alushi. Në datë 04.04.2022 është kredituar shuma 950.000 lekë, përfitues B. C, përshkrimi “kthim detyrimi sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 20.08.2018”;
- Nxjerrje llogarie të pagave nga Credins Bank e datës 22.05.2024, për shtetasin B. C, për periudhën 02.06.2010 - 04.04.2013;

- Nxjerje llogarie të pagave nga Raiffaisen Bank e datës 22.05.2024, për shtetasin B. C, nga data 29.03.2013 deri në datën 29.04.2013;
- Vërtetim nr. 322, date 23.05.2024, për të ardhurat e realizuara nga shtetasi B. C, në periudhën 2008 – mars 2013.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare lëshuar nga Prefektura e Qarkut Durrës, për periudhën 01.01.2011 - 31.12.2014.

### **Konkluzion:**

- *Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion justifikues ligjor, në lidhje me huanë në shumën 950.000 lekë si dhe shpjegime për burimin e shlyerjes së saj. Kthimi i detyrimit është kryer me transfertë bankare, në datë 04.04.2022.*
- *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.*
- *Shtetasi B. C, ka patur të ardhura të mjaftueshme, me qëllim dhënien hua të vlerës prej 950.000 lekë, subjektit të vlerësimit në datë 20.08.2018.*
- *Subjekti i vlerësimit ka patur të ardhura të mjaftueshme me qëllim kthimin e huasë shtetasit B. C në vlerën prej 950, 000 lekë në datë 04.04.2022.*

6. Kontratë huaje nr. rep., \*\*\* dhe nr. kol., \*\*\*, datë 17.09.2018, për shumën 15.000 usd dhe 6.000 euro, nga A. F, për blerjen e një apartamenti me afat shlyerje deri në 16.08.2023. Kthyer detyrimi me Fibank në datë 21.10.2020. Likuiduar. **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 17.08.2018, me deklarues Elton Alushi dhe A. F, ku Elton Alushi deklaroi se do të marrë në formë huaje në datë 17.08.2018, kumatit të tij, shtetasit A. F, shumën prej 6.000 euro dhe 15.000 usd. Kjo shumë do të jepet hua nëpërmjet bankës, pa interes dhe me një afat shlyerje 5 vjeçar nga data e nënshkrimit të deklaratës, me qëllim blerjen e një apartamenti në Tiranë. Deklaruesi, A. F, deklaroi se këto të ardhura i ka siguruar nga shitja e një apartamenti në pronësi të tij.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie bankare të Elton Alushi, në monedhën lekë, euro dhe usd, ku rezultojnë veprimet si më poshtë:

#### Monedha lekë:

- Në datë 06.07.2020, kredituar llogaria nga transfertat në vlerën 4.596.150 lekë, kalim fondi.
- Në datë 08.07.2020, debituar llogaria në vlerën 5.900.050 lekë, kalim për këmbim.

#### Monedha euro:

- Në datë 20.08.2018, kredituar llogaria në vlerën rreth 6.000 euro nga A. F, kalim sipas deklaratës me nr. \*\*\*, datë 17.08.2018.
- Në datë 08.07.2020, kredituar shuma 47.504 euro, nga euro me kurs 124.2 lekë.



## Monedha usd

- Në datë 20.08.2018, kredituar llogaria në vlerën 14.914,75 usd nga A. F, me përshkrimin kalim sipas deklaratës me nr. \*\*\*, datë 17.08.2018.

**Fibank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogari bankare në emër të Elton Alushi, i cili në datë 21.10.2020, ka depozituar shumën 20.000 euro, e cila është transferuar në llogari të A. F, me përshkrimin “kthim detyrimi sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 17.08.2018”. Llogaria figuron e mbyllur në datë 21.10.2023.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024 subjektit i’u kërkua dokumentacion në lidhje me burimin financiar të huadhënësit dhe shlyerja e saj.

Në procesverbalin e datës 16.2.2024, subjekti ka sqaruar se huanë e ka marrë nga kunati i tij, A. F dhe se burimi është shitja e një apartamenti. Paraqiti dokumentacion justifikues ligjor.

Referuar deklaratimit të tij, në kontratën e huasë nr. rep., \*\*\* dhe nr. kol., \*\*\*, datë 17.09.2018, subjekti sqaroi se ka bërë lapsus në muajin e deklaruar i cili duhet të ishte i tetë.

Subjekti ka sqaruar se pagesa është bërë nga tërheqja në llogarinë e tij pranë Raiffeisen Bank, në datën 21.10.2020, të shumës 20.000 euro, me burimet e të ardhurat nga shitja e apartamentit. Pagesa është bërë po atë ditë, në Fibank, për të cilën subjekti paraqiti dokument. Sqaron se, vlera e borxhit të kthyer është në shumën rreth 20.000 euro, (me konvertim të përafërt). **Paraqiti:**

- Kontratë shitje pasuri të paluajtshme datë 01.11.2010, nënshkruar ndërmjet palës shitëse shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k dhe palës blerëse A. F, me objekt shitjen e pasurisë të llojit apartament me nr. \*\*\*, sip. 96.3 m<sup>2</sup>, në Yzberisht, Tiranë, me vlerë 47.668 euro.
- Kontratë shitblerje me rezervë, e pasurisë apartament, nr. \*\*\*, datë 21.08.2017, me shitës A. F dhe palë blerëse A. K dhe M. K, të pasurisë nr. \*\*\*, apartament me sip. 96.3 m<sup>2</sup>, në Yzberisht, Tiranë, në shumën 47.500 euro. Pala blerëse ka paguar shumën 9.500 euro, me nënshkrimin e kontratës dhe diferencën në shumën 38.000 euro, do ta kalojë në llogarinë e noterit nëpërmjet bankës Union.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 19.11.2010, të apartamentit me sip. 96.3 m<sup>2</sup>, në emër të A.F, bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme dhe praktika përkatëse.
- Tërheqje nga llogaria datë 21.10.2020, pranë Raiffeisen Bank, nga Elton Alushi, të shumës 20.000 euro. Rezervim për tërheqje shume në datë 16.10.2020, në Raiffeisen Bank.
- Urdhër pagesë datë 21.10.2020, pranë Fibank, nga Elton Alushi, me përfitues A. F, të shumës 20.000 euro, me përshkrimin “kthim detyrimi sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 17.08.2018”.

Me postën elektronike të datës 11.03.2024, subjekti sqaroi se kunati A. F, nuk ka kryer asnjë investim gjatë periudhës që ka dhënë huanë.

Me emailin e datës 09.05.2024, subjekti i vlerësimit ka vënë në dispozicion të Trupës së Vlerësimit, dokumentacionin mbi kalimin e shumës prej 38.000 euro në llogari të A. F, sipas

kontratës së shitblerjes, konkretisht nxjerrje llogarie bankare në monedhën lekë dhe euro pranë Union Bank në emër të A. F, nga ku konstatohet:

#### Monedha lekë:

- Më datë 26.10.2017, është kredituar vlera prej 1.200.000 lekë me përshkrimin “A. M për tjetërsim pasurie për A. F, kalim sipas kontratës nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 21.08.2017.
- Më datë 26.10.2017, A. F tërheq nga llogaria vlerën 1.200.000 lekë.
- Më datë 09.11.2017, është kredituar vlera prej 489.695 lekë me përshkrimin “A. M për A. F, kalim kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 21.08.2017.
- Më datë 10.11.2017, A. F tërheq nga llogaria vlerën 489.000 lekë.

#### Monedha euro:

- Më datë 09.11.2017, është kredituar vlera prej 34.074 euro me përshkrimin “A. M për A. F, kalim kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 21.08.2017.
- Më datë 10.11.2017, A. F tërheq nga llogaria vlerën 10.000 euro.
- Më datë 13.11.2017, A. F tërheq nga llogaria vlerën 24.077 euro.

#### Konkluzion:

- *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank dhe Fibank.*
- *Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion në lidhje me huanë e marrë në vitin 2018 dhe shlyerjen në muajin tetor 2020, kunatit të tij, shtetasit A. F, me burim financiar të ardhurat nga shitja e një apartamenti në vitin 2017.*
- *Subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme, me qëllim shlyerjen e detyrimeve kundrejt A. F, në vlerën 20.000 euro.*

#### Deklarimi i shpenzimeve të subjektit të vlerësimit.

Në mbështetje të nenit 33, pika 1/ç, d, dh, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i cili i nënshtrohet vlerësimit, deklaron shpenzimet e vitit të fundit për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha pagesat periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të tij ose të personave të lidhur; udhëtimet private personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen, shpenzimet e përballuara; arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, në momentin e deklaramit apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve.

✚ Në mbështetje të nenit 33, pika 1/ç, subjekti deklaron:

1. Shpenzime për drita për një vit, vlera 29.856 lekë.
2. Shpenzime për uji, vlera 14.000 lekë.
3. Shpenzime interneti, vlera 24.000 lekë.

4. Shpenzime telefoni (unë bashkëshortja dhe fëmijët), vlera 28.000 lekë.

**Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në emër të Elton Alushi, Qendra TR1, me nr. kontrate AL\*\*\*004, në adresën rr. “\*\*\*\*”, Tiranë.
- Kontratë me Ujësjiellës Kanalizime, qyteti Tiranë, në emër të Elton Alushi, në zonën \*\*\*, kontrata \*\*\*, në adresën rr. “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, kati \*\*\*.

**Procedura e vlerësimit:**

**Furnizuesi i Shërbimit Universal**, me shkresën nr. 60/32 prot., datë 17.08.2023, konfirmon se në emër të Elton Dilaver Alushi, figuron kontratë e furnizimit me energji elektrike nr. AL\*\*\*9004, në Instancën Tiranë, bashkëlidhur kopje e të dhënave të klientit Elton Alushi, me kontratë nr. AL\*\*\*9004, Kabina “\*\*\*\*”, qarku Tiranë. Pagesat për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022, janë ne vlerën 29.856 lekë.

Gjithashtu, me gjeneralitetet Elton Alushi, figurojnë të regjistruara 11 kontrata të furnizimit me energji elektrike, ku një kontratë është e regjistruar në qarkun Elbasan dhe 10 kontrata ne Qarkun Vlorë.

**Shoqëria Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime Tiranë**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 06.09.2023, konfirmon se në emër të Elton Alushi figuron kontrata nr. \*\*\*, në objektin me adresë rr. “\*\*\*\*” me status “Aktiv”, në kategorinë konsumatore familjare, me detyrime të likuiduara deri në muajin qershor 2023. Bashkëlidhur, fletët SMI, ku konfirmohet pagesa për vitin 2022, në shumën 14.628 lekë. Bashkëlidhur kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 22.08.2018.

Në emër të Elsa Alushi, figuron e regjistruar kontrata nr. \*\*\*381-1, në objektin me adresë rr. “\*\*\*\*”, me status “kontratë e pezulluar në kategorinë konsumatore familjare, me detyrime të likuiduara deri në qershor 2023”. Nga kontrolli në arkivin e Ujësjiellës Kanalizime Tiranë, nuk disponohet asnjë dokument që të vërtetojë se Elsa Alushi ka të njëjtat gjeneralitete me personin e kërkuar në shkresë. Bashkëlidhur, fletët SMI.

**14 Shoqëritë Rajonale Ujësjiellës - Kanalizime**, nuk konfirmojnë kontrata te lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Vodafone Albania sh.a.**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 03.11.2023, konfirmon si më poshtë:

Shtetasit Elton Alushi, i korrespondojnë numrat celularë si më poshtë:

- ✓ Numri celular +35569\*\*\*650 inaktiv, përdorur nga data 30.06.2018, deri në datë 01.10.2019.
- ✓ Numri celular +35569\*\*\*844 inaktiv, përdorur nga data 28.06.2019, deri në datë 07.04.2021.
- ✓ Numri celular +35569\*\*\*6911 inaktiv, përdorur nga data 04.12.2020, deri në datë 07.03.2022.
- ✓ Numri celular +35569\*\*\*2046 inaktiv, përdorur nga data 09.08.2007, deri në datë 19.03.2022.
- ✓ Numri celular +35569\*\*\*1580 inaktiv, përdorur nga data 12.03.2015, deri në datë 08.11.2019.

Në lidhje me numrat, +35569\*\*\*6911 dhe +35569\*\*\*2046, nuk rezultojnë pagesa për vitin 2022.

Në emër të Komisarariatit të Policisë nr. 3, Tiranë Co: Elton Alushit i rezulton numri celular +35569\*\*\*2222, aktiv nga data 22.10.2015, ku pagesat për vitin 2022, janë në shumën 7.060 lekë.

Shtetases Elsa Ylli Alushi i korrespondojnë numrat celularë si më poshtë:

- ✓ Numri celular +35569\*\*\*5559, aktiv më datë 30.05.2007, ku pagesat për vitin 2022 janë në shumën 15.700 lekë.
- ✓ Numri celular +35569\*\*\*4227 inaktiv, përdorur nga data 13.06.2019 deri në datë 19.04.2022, nuk ka pagesa për vitin 2022.
- ✓ Numri celular +35569\*\*\*6632 aktiv nga data 28.02.2023. Bashkëlidhur praktika përkatëse.

**One Albania sh.a.**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.08.2023, konfirmon se në emër të Elton Alushi, figurojnë të regjistruar numrat 069\*\*\*4887, ku totali i pagesave për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, është në vlerën 800 lekë dhe numri 068\*\*\*3370, ku totali i pagesave për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 është në vlerën 800 lekë. Bashkëlidhur praktika përkatëse, kopje të kartave Id, në emër të Elton Alushi, me datëlindje 14.04.1991, (nuk është i njëjti person me kërkesën e shkresës).

Gjithashtu, konfirmon se në emër të Elsa Alushi, figurojnë të regjistruar numrat 068\*\*\*3347, ku totali i pagesave për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, është në vlerën 600 lekë dhe numri 068\*\*\*3281, ku totali i pagesave për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 është në vlerën 1.000 lekë, bashkëlidhur praktika përkatëse.

**Albania Satellite Communications sh.p.k.**, me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 31.08.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Abissnet sh.a.**, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 04.09.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Digicom sh.a.**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, konfirmon se Elton Alushi ka të lidhur kontratë nr. DG-\*\*\*T, më datë 03.02.2019, me faturë mujore 1.990 lekë me afat 24 muaj, e cila vazhdon të jetë aktive.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjekti u pyet në lidhje me konstatimet e institucioneve të mësipërme.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, në lidhje me konstatimet e Furnizuesit të Shërbimit Universal, për 11 kontratat, subjekti sqaroi se, kontrata e vetme e tij me Furnizuesin e Shërbimit Universal është ajo e banesës së deklaruar në rr. “\*\*\*”, ndërsa të gjitha kontratat e tjera nuk kanë asnjë lidhje me të apo familjarët e tij. Subjekti konfirmon pagesën e vërtetuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal në shumën 29.856 lekë.

Sqaron se, ai ka vetëm një kontratë me Ujësjellës Kanalizime Tiranë, për të cilën ka paraqitur kopje të librezës me nr. kontrate \*\*\* dhe institucioni përkatës e konfirmon këtë kontratë me nr. \*\*\*. Deklaron me përgjegjësi të plotë se është e njëjta kontratë. Konfirmon pagesën nga Ujësjellës Kanalizime Tiranë, në shumën 14.628 lekë.

Subjekti konfirmon pagesat për numrat telefonik të përdorur nga ai, nga familjarët e tij, konkretisht, Elsa, djali Altoneli dhe vajza Ermela, pranë kompanive Vodafone Albania, dhe nga One Albania.

Subjekti konfirmon shpenzimet e internetit pranë Digicom sh.a, në shumën rreth 2.000 lekë në muaj.

Me postën elektronike të datës 11.03.2024, subjekti sqaroi se bashkëshortja Elsa Ylli Alushi nuk ka patur asnjëherë kontratë dhe nuk ka disponuar asnjëherë ambient në asnjë formë të posedimit të saj, qira, pronësi apo administrim.

### **Konkluzion:**

- ***Shpenzimet e deklaruara për ujë, drita, telefon dhe internet gjatë periudhës së sipërcituar, janë në vlerën totale rreth 93.000 lekë.***

✚ Në mbështetje të nenit 33, pika 1/d, subjekti deklaron:

- Udhëtim në shtetin grek në Athinë, së bashku me fëmijët dhe nënën Liria Alushi, nga data 30.12.2022 deri në 02.02.2023, tek familjarët e mi. Vlera 300 euro.
- Udhëtim i bashkëshortes Elsa Alushi, në Francë, qyteti Nice, udhëtim i sponsorizuar nga firma farmaceutike “\*\*\*\* Farm”, prej datës 08.10.2022 deri në datën 12.10.2022. Nuk ka kryer pagesë.
- Udhëtim, unë, bashkëshortja dhe dy fëmijët, në shtetin grek, në Athinë, për vizitë familjare nga data 21.06.2022 deri në datën 28.06.2022. Vlera 800 euro.
- Udhëtim i bashkëshortes dhe dy fëmijëve në shtetin francez, qyteti Toulouse, tek motra e saj, nga data 01.05.2022 deri në datën 09.05.2022. Vlera 800 euro.
- Udhëtim i bashkëshortes Elsa Alushi në Spanjë, qyteti Madrid, udhëtim i sponsorizuar nga firma farmaceutike “\*\*\*\* Farm” prej datës 16.01.2022 deri në datën 19.01.2022. Nuk ka kryer pagesë.
- Udhëtim i bashkëshortes Elsa Alushi, në Holandë, qyteti Amsterdam, udhëtim i sponsorizuar nga firma farmaceutike “\*\*\*\* Farm” prej datës 06.03.2020 deri në datën 09.03.2020. Nuk ka kryer pagesë.

### **Procedura e vlerësimit:**

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjektit i’u kërkua të paraqesë kopje të sistemit TIMS dhe shpjegime në lidhje me deklarinimin.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti sqaroi se bashkëshortja ka udhëtuar në vende të ndryshme për trajnime të organizuara nga firma farmaceutike, me shpenzimet e tyre, konkretisht firma farmaceutike “\*\*\* Farm”.

Bashkëshortja ka udhëtuar për qëllime trajnime, konkretisht në qytetin Amsterdam, në Holandë, prej datës 06.03.2020 deri në datën 09.03.2020 dhe në Spanjë, qyteti Madrid, prej datës 16.01.2022 deri në datën 19.01.2022. Gjithashtu, bashkëshortja ka udhëtuar në Francë, qyteti Nice, prej datës 08.10.2022 deri në datën 12.10.2022, me shpenzimet të cilat janë kryer nga këto firma.

Subjekti sqaroi se, bashkëshortja dhe dy fëmijët e saj kanë udhëtuar për në Francë, qyteti Toulouse, tek motra e bashkëshortes nga data 01.05.2022 deri në datën 09.05.2022, nëpërmjet linjës ajrore Wizz Air Barcelonë dhe kthimi nga Milano. Bashkëshortja ka lëvizur me linja transit.

Subjekti ka udhëtuar me bashkëshorten dhe dy fëmijët në shtetin grek, në Athinë, për vizitë familjare nga data 21.06.2022 deri në datën 28.06.2022, me mjetin e tyre me targë AA \*\*\* MR, dhe sqaroi se sistemi ka të regjistruar vetëm datën e hyrjes, (mund të këtë pasur problem sistemi).

Subjekti ka udhëtuar me bashkëshorten dhe dy fëmijët në shtetin grek, në Athinë dhe nënën Liri Alushi, nga data 30.12.2022 deri në 02.01.2023, te familjarët e tij. Sqaroi se, ka deklaruar kthimin në 2 shkurt ndërkohë që është lapsus, janë kthyer më datë 2 janar 2023. Udhëtimet në Greqi janë bërë me mjetin e subjektit me targa AA \*\*\* MR, kanë pasur për qëllim takimin me familjarët e tij, fjetja është bërë tek banesa e vëllait të subjektit në Athinë. **Paraqiti:**

- Konfirmim nga sistemi TIMS, në emër të Elton Alushi, për periudhën janar 2020 - dhjetor 2022, ku vërtetohen hyrje - daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë, konkretisht:
- ❖ Dalje në datë 30.12.2022, hyrje në datë 02.01.2023, pranë Pikës Kufitare Kakavijë, me mjetin me targë AA \*\*\* MR.
- ❖ Hyrje në datë 28.06.2022, pranë Pikës Kufitare Qafë Botë, me mjetin me targa AA \*\*\* MR.
- Konfirmim nga sistemi TIMS, në emër të Elsa Alushi, për periudhën janar 2020 - dhjetor 2022, ku vërtetohen hyrje - daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë, konkretisht:
- ❖ Dalje në datë 06.03.2020, hyrje datë 09.03.2020, pranë Komisarariatit Rinas, me linjë ajrore Transavia Hollandë.
- ❖ Dalje në datë 16.01.2022, hyrje në datë 19.01.2022, pranë Komisarariatit Rinas, me linjë ajrore Wizz Air Madrid.
- ❖ Dalje në datë 01.05.2022, hyrje datë 09.05.2022, pranë Komisarariatit Rinas, me linjë ajrore Wizz Air Barcelona - kthimi me Wizz Air Milano.
- ❖ Hyrje në datë 28.06.2022, pranë Pikës Kufitare Qafë Botë, me mjetin me targa AA \*\*\* MR.
- ❖ Dalje në datë 08.10.2022, hyrje në datë 12.10.2022, pranë Komisarariatit të Policisë Kufitare Rinas, me linjë ajrore Wizz Air Nice.
- ❖ Dalje në datë 30.12.2022, hyrje në datë 02.01.2023, pranë Pikës Kufitare Kakavijë, me mjetin me targë AA \*\*\* MR.

- Konfirmim nga sistemi TIMS, në emër të Altonel Alushi dhe vajza Ermela Alushi, për periudhën janar 2020 - dhjetor 2022, ku vërtetohen hyrje - daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë, konkretisht:
- ❖ Dalje në datë 30.12.2022, hyrje në datë 02.01.2023, pranë Pikës Kufitare Kakavijë, me mjetin me targë AA \*\*\* MR.
- ❖ Hyrje në datë 28.06.2022, pranë Pikës Kufitare Qafë Botë, me mjetin me targë AA \*\*\* MR.
- ❖ Dalje në datë 01.05.2022, hyrje datë 09.05.2022, pranë Komisarariatit të Policisë Kufitare Rinas, me linjë ajrore Wizz Air Barcelona, kthimi me Wizz Air Milano.
- Ftesë në datë 29.09.2022, nga “\*\*\* Pharma” në Nice, Francë, në emër të Elsa Alushi (dokument në gjuhën angleze).
- Ftesë në datë 20.12.2021, nga “\*\*\* Pharma” në Madrid, Spain, në emër të Elsa Alushi (dokument në gjuhën angleze).

### **Konkluzion:**

- ***Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje - daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë gjatë periudhës 2020 - 2022 të subjektit dhe personave të lidhur me të.***
- ***Shpenzimet për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipërcituar janë deklaruar në total rreth 218.000 lekë.***

✚ Në mbështetje të nenit 33, pika 1/dh, subjekti deklaron:

1. Arsim i Lartë në Fakultetin e Drejtësisë dhe Master Profesional “E drejtë penale”, nga viti 2011 deri në vitin 2017, në vlerën 198.000 lekë. Bashkëlidhur:
2. Pagesë për dhënie provim gjuhe e huaj SAT e Altonel Alushi, në vlerën 104 euro.

### **Procedura e vlerësimit:**

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjekti u pyet në lidhje me shpenzimet e shkollimit për bashkëshorten dhe fëmijët, si dhe dokumentacionin.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti sqaroi se fëmijët kanë studiuar në shkolla publike, konkretisht, vajza dhe djali arsimin 9- vjeçar e kanë kryer në shkollën “Pjetër Budi”. Djali shkollën e mesme e ka kryer në shkollën “Petro Nini Luarasi”, në Tiranë. Bashkëshortja ka kryer master në vitin 2011 - 2013 dhe tarifa e shkollimit ka qenë në shumën 120.000 lekë, me burim nga pagat. Subjekti ka sqaruar se ka qenë një harresë mos pasqyrimi i këtyre shpenzimeve.

Referuar dokumentacionit për pagesën e shkollimit të tij, pranë Fakultetit të Drejtësisë, për periudhën 2011 - 2017, saktësoi se shuma e paguar është 220.740 lekë. **Paraqiti:**

- Vërtetim datë 02.02.2024, nga Shkolla 9 - vjeçare “Pjetër Budi”, që konfirmon se Altonel Alushi ka qenë nxënës nga viti 2011 – 2020, bashkëlidhur kopje të dëftesave në gjimnazin “Petro Nini Luarasi”, në emër të Altonel Alushi për periudhën 2020 - 2022.
- Vërtetim datë 02.02.2024 nga Shkolla 9 - vjeçare “Pjetër Budi”, që konfirmon se Ermela Alushi ka qenë nxënëse për periudhën 2014 - 2023.
- Vërtetim nr. 319/1 prot., datë 05.02.2024, nga Fakulteti i Mjekësisë që vërteton se Elsa Alushi për periudhën 2011 - 2013, ka kryer ciklin e tretë të studimeve në programin “Mjek familje”, me pagesë në total në shumën 120.000 lekë, bashkëlidhur mandat pagesën në Credins Bank, në datë 17.02.2013, në shumën 60.000 lekë, mandat pagesë në Credins Bank, në datë 16.03.2011, në shumën 60.000 lekë, me përshkrimin “Tarifë shkollimi”.
- Vërtetim nr. 111/3 prot., datë 06.02.2024, nga Fakulteti i Drejtësisë, që vërteton se Elton Alushi ka kryer pagesën e tarifës së shkollimit për vitin akademik 2011 - 2017, në shumën 220.750 lekë.

### **Konkluzion:**

- *Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e personave të lidhur gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, rezultojnë në total rreth 353.000 lekë.*

## **DEKLARIMI I BASHKËSHORTES – ELSA ALUSHI**

### **Deklarimi i pasurisë**

Bashkëshortja e subjektit të vlerësimit, Znj. Elsa Alushi, në pasqyrën e deklarimit të pasurive dhe burimit të krijimit, ka deklaruar pasuritë si më poshtë:

1. Tokë arë, në Fratar, Mallakastër, së bashku me familjen e saj, me sipërfaqe 22, 538 m<sup>2</sup>. Pjesa takuese 1/10. **Bashkëlidhur deklaratës:**
  - Akti i marrjes së tokës në pronësi nr. 3722, datë 10.05.1995, i jepet familjes së Y. F, tokë bujqësore me sipërfaqe totale 22, 538 m<sup>2</sup>, në fshatin Dames, Mallakastër.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Agjencia Shtetërore e Kadastrës,** nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të Elsa Alushi.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjektit i’u kërkua dokumentacion plotësues dhe shpjegime.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti ka sqaruar se toka bujqësore e përfitur nga bashkëshortja është marrë sipas Ligjit nr. 7501. Referuar certifikatës familjare, në vitin 1991, bashkëshortja figuron anëtare e familjes “Filaj”, rrjedhimisht, zotëron 1/8 pjesë të tokës bujqësore ose 12.5 % të kësaj pasurie, (është një lapsus në deklaram). Toka bujqësore ka qenë e investuar, pasi janë marrë ullinj të mbjellë që nga sistemi i kaluar dhe po kështu janë mbjellë pemë frutore të ndryshme dhe kultura bujqësore. Familja e bashkëshortes ka përfitur prodhime bujqësore dhe



blegtorale, nga prindërit e saj. Subjekti dhe bashkëshortja nuk kanë kryer investime në këtë tokë bujqësore. **Paraqiti:**

- Certifikatë familjare të vitit 1991, me 8 anëtarë të familjes “Filaj” duke përfshirë dhe shtetasen Elsa Filaj, (bashkëshortja e subjektit të vlerësimit).

### **Konkluzion:**

- *Subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me tokën bujqësore të përfutuar nga Ligji nr. 7501, e kultivuar me prodhime bujqësore.*
- *Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk e konfirmon pasurinë të regjistruar në emër të Elsa Alushi.*
- *Subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegime lidhur me pjesën takuese të bashkëshortes lidhur me këtë pasuri.*

2. Llogari rrjedhëse tek Tirana Bank në vlerën 194.034 lekë. Pjesa takuese 100%.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon se Elsa Alushi ka llogari rrjedhëse me balancë në datë 09.03.2023, në vlerën 222.901 lekë.

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarisë së bashkëshortes së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk linden dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari bankare. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar.***

***Referuar të dhënave financiare, Znj. Alushi ka pasur të ardhura të ligjshme me qëllim kursimin e vlerës prej 222.901 lekë më datë 09.03.2023.***

3. Depozitë në euro tek Credins Bank, kryer shkëmbim nëpërmjet bankës nga llogaritë rrjedhëse të pagave ndër vite. Vlera 27.720 euro. Pjesa takuese 100%.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 02.10.2023, konfirmon se Elsa Alushi ka depozitë 6 mujore, me balancë në datë 09.03.2023, në vlerën 27.720 euro. Bashkëlidhur, llogari bankare në lekë dhe në euro, konkretisht:

- Në datë 10.08.2022, nga llogaria e pagës është debituar vlera 2.348.000 lekë, me përshkrim këmbim në llogari, konvertim.
- Në datë 11.08.2022, janë arkëtuar vlerat 600.000 lekë dhe 300.000 lekë, me përshkrimin kalim shume në llogari personale.

- Në datë 11.08.2022, vlera 900.000 lekë, është debituar me qëllim këmbim në llogari, konvertim.
- Në llogarinë e monedhës euro, në datën 10.08.2022, kredituar vlera 20.068 euro dhe në datë 11.08.2022, kredituar vlera 7.659 euro, me përshkrimin këmbim në llogari, konvertim.
- Në datë 11.08.2022, vlera prej 27.720 euro, ka kaluar në depozitë me afat, e cila është gjendje deri në datë 09.03.2023.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjekti u pyet në lidhje me burimin financiar për depozitën e bashkëshortes.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti sqaroi se burimi kanë qenë të ardhurat nga paga e saj ndër vite si mjekje, honorarë, dieta të cilat janë këmbyer në bankën Credins.

### **Konkluzion:**

Trupa e Vlerësimit konstaton se:

- *Llogaria bankare në Credins Bank është krijuar në muajin gusht 2022.*
  - *Të ardhurat nga pagat e Elsa Alushi për periudhën 2020 - 2022, janë në shumën rreth 4.000.000 lekë.*
  - *Subjekti dha shpjegime në lidhje me burimin financiar që ka shërbyer për krijimin e depozitës bankare në Credins Bank në emër të bashkëshortes.*
  - *Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e ardhur nga Credins Bank.*
  - *Bashkëshortja e subjektit të vlerësimit, referuar analizës financiare, ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme me qëllim kursimin e vlerës prej 27.720 euro në datë 09.03.2023.*
4. Llogari rrjedhëse në lekë të pagave tek Credins Bank, kryer ndër vite. Vlera 654.329 lekë. Pjesa takuese 100%.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 02.10.2023, konfirmon se Elsa Alushi ka llogari page me balancë në datë 09.03.2023, në vlerën 739.257 lekë. Bashkëlidhur, llogari bankare në lekë, konkretisht:

Më datë 23.07.2020, janë transferuar në llogarinë e subjektit të vlerësimit 1.172.500 lekë, me përshkrimin kalim tek bashkëshorti. (Trajtuar më lart në llogarinë në euro të Elton Alushi).

Gjithashtu Credins Bank, konfirmon se më datë 08.11.2013, Elsa Alushi ka arkëtuar vlerën 180.000 lekë dhe vlerën 246.968 lekë, duke i kaluar në një depozitë me afat 6 mujore po në të njëjtën datë me vlerë 427.078 lekë.

Në datë 17.11.2014, Elsa Alushi ka tërhequr nga depozita vlerën prej 437.898 lekë (përfshirë interesat).

Trupa e Vlerësimit, ka kryer një procedurë verifikimi të llogarive të bashkëshortes së subjektit të vlerësimit, sipas nenit 34, pika 3/1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ku rezulton se ***nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këto llogari bankare. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e administruar.***

Referuar analizës financiare, bashkëshortja e subjektit të vlerësimit, ***ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme me qëllim kursimin e vlerës prej 739.257 lekë në datë 09.03.2023.***

***Gjithashtu bashkëshortja e subjektit të vlerësimit, ka pasur të ardhura të mjaftueshme me qëllim çeljen e depozitës më datë 08.11.2013 me vlerë rreth 427.078 lekë.***

### **Deklarimi i të ardhurave nga personi i lidhur me subjektin e vlerësimit**

- Të ardhura nga paga si mjeke familje, nga data 01.04.2004 deri në datën 01.03.2023 dhe nga paga pranë Kompanisë Altec. Vlera 10.503.000 lekë.
- Të ardhura nga kontrata me farmacinë Delta Pharma dhe Bilim, për prezantimin e preparateve mjekësore nga data 01.12.2015 deri 01.03.2023. Vlera 595.000 lekë.
- Të ardhura nga paga ime, e përfituar nga kontrata me Global Security, si mjeke, nga data 01.11.2018 deri në datën 01.03.2023. Vlera 1.560.000 lekë. **Bashkëlidhur deklaratës:**
- Vërtetim nr. 253, prot., datë 22.02.2018, nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Fier, që konfirmon se Elsa Filaj ka lidhur kontratë pune me këtë drejtori në pozicionin e mjekes së përgjithshme të familjes, me pagë mujore bruto 55.014 lekë dhe pagë mujore neto në vlerën 45.821 lekë.
- Vërtetim nr. 128, prot., datë 08.11.2013, nga Qendra Shëndetësore nr. 6, Tiranë, që konfirmon se Elsa Alushi është punonjëse pranë kësaj qendre, në pozicionin e mjekes së përgjithshme të familjes, me pagë mujore bruto 60.190 lekë dhe pagë mujore neto në vlerën 47.400 lekë.
- Kontratë individuale datë 01.11.2018, midis punëdhënësit Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike Global Security sh.p.k dhe punëmarrëse Elsa Alushi, si mjeke e shoqërisë, me pagë në vlerën 34.450 lekë në muaj.
- Kontratë konsulencë, datë 01.12.2015, midis punëdhënësit Delta Pharma Al, dhe mjek i përgjithshëm Elsa Alushi, si konsulente, me një pagë neto 100.000 lekë/muaj, e cila do të kalojë në Credins Bank.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie bankare të Elsa Alushi, ku gjatë periudhës 29.04.2005 - 03.10.2008 janë kredituar pagat në vlerën rreth 1.322.840 lekë.

**Banka Kombëtare Tregtare**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie bankare të Elsa Alushi, ku gjatë periudhës 04.11.2008 - 11.08.2020, janë kredituar pagat nga “ASHR dhe Global Security”, në vlerën 1.963.415 lekë.

**Tirana Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie bankare të Elsa Alushi, ku gjatë periudhës 12.11.2020 - mars 2023, janë kredituar pagat në vlerën 840.768 lekë.

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 02.10.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie bankare të Elsa Alushi, ku janë kredituar pagat nga Qendra Shëndetësore nr. 6, Delta Pharma - AL, Altec sh.p.k, Bilim IlacSan Ve tik, për periudhën 01.04.2013 - tetor 2014 dhe 01.04.2016 - mars 2023, në vlerën 7.346.672 lekë.

Credins Bank, konfirmon se më datë 29.06.2021, Elsa Alushi ka kryer pagesën e tatimeve mbi të ardhurat individuale për periudhën janar – dhjetor 2020, në vlerën 55.652 lekë.

**OTP Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.08.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie bankare të Elsa Alushi, ku janë kredituar pagat për periudhën 01.09.2014 - 01.03.2016, në vlerën 1.035.153 lekë.

**Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, konfirmon se Elsa Alushi ka përfituar të ardhura nga punësimi pranë “Poliklinika nr. 10, Poliklinika nr. 6, Valbona Begolli, Alb Pastrim Altec, Global Security shpk”, për periudhën mars 2013 - qershor 2023.

#### **Paraqiti:**

- Vërtetim nga FSDKSH nr. 1528/1, datë 29.12.2023, që konfirmon të ardhurat nga paga në emër të Elsa Alushi për periudhën tetor 2003 - maj 2005, në vlerën 975.747 lekë.

Me emailin e datës 09.05.2024, subjekti i vlerësimit ka deklaruar se në çdo rast është bërë pagesa nga bashkëshortja, pasi është njoftuar zyra e financës së Global Security shpk për detyrimin vjetor që ajo ka tek administrata tatimore. Në vitin 2021, nuk është njoftuar bashkëshortja nga zyra e financës së Global Security shpk, kjo mbase dhe për efekt të pandemisë dhe shtyrjeve të afateve. Shlyerja e këtij detyrimi është kryer më vonë.

#### **Bashkëlidhur:**

- Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave të Elsa Alushi për periudhat tatimore 20-A, në vlerën 55.652 lekë; 21-A, në vlerën 58.332 lekë; 22-A, në vlerën 62.384 lekë; 23-A, në vlerën 74.530 lekë.
- Mandat pagesë pranë Credins Bank, në shumën 84.862 lekë nga Elsa Alushi, për tatime dhe sigurime shoqërore për periudhën janar- dhjetor 2021.

#### **Konkluzion:**

- *Të ardhurat neto të bashkëshortes paga, honorarë etj., për periudhën tetor 2003 - 09.03.2023, të dokumentuara, janë në shumën 13.485.000 lekë.*
- *Subjekti i vlerësimit ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me pagesat e detyrimeve tatimore të Elsa Alushi, që llogariten në vlerën totale rreth 250.898 lekë.*
- *Për periudhën objekt vlerësimi janë paguar detyrimet tatimore në vlerën 140.514 lekë.*

- ✚ Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti Elton Alushi ka deklaruar adresën ku është regjistruar në Gjendjen Civile, si dhe adresën ku banon: “Njësia Administrative nr. 5, Rruga \*\*\*\*, Kompleksi \*\*, ap. \*\*.

Në deklaratat periodike vjetore ndër vite, ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në gjendjen civile, si dhe adresën e plotë ku banon: “Njësia Bashkiake nr. 7, rr. \*\*\*\*, “Pallati \*\*\*\*”, Tiranë; “Njësia Bashkiake nr. 7, rr. \*\*\*\*, rr. \*\*\*\*” (Unaza e Re), Pallati \*\*\*\*”. **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Certifikatë familjare, datë 11.04.2018, të familjes “Alushi”, regjistruar në Njësia Bashkiake nr. 7, Tiranë, Kopje të kartave Id, kopje pasaporte.
- Certifikatë personale datë 11.04.2018, në emër të Elton Alushi, i cili figuron i regjistruar në vendbanimin: Njësia Bashkiake nr. 7, rr. \*\*\*\*, Tiranë.
- Vlerësimi i rezultateve në punë, në emër të Elton Alushi.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjekti u pyet në lidhje me adresat e deklaruara.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti sqaroi se adresa e deklaruar në rr. \*\*\*\*, Njësia Administrative nr. 7, është një adresë, ku ka bërë regjistrimin në gjendjen civile kur është transferuar në Tiranë, me punë. Në periudhën qershor 2004 - 2007, ka jetuar në një apartament tek ish - fusha e aviacionit, e cila në atë kohë mbante emrin e rr. \*\*\*\*.

Subjekti paraqiti deklaratë datë 16.02.2024, nga shtetasi Xh. Sh dhe sqaron se apartamenti i regjistruar në emër të Xh. Sh, figuron ne rr. \*\*\*\*, Tiranë, referuar dhe kartelës së pasurisë. Ndryshimi midis emërimit të rr. \*\*\*\* dhe rr. \*\*\*\* ka ndodhur për shkak të adresarit të ri (ndryshimi i rrugëve). Për fundjavë shkonte në shtëpinë e tij ose tek shtëpia e prindërve të bashkëshortes. Bashkëshortja ka jetuar në shtëpinë e prindërve të saj gjatë kësaj periudhe (janë martuar në vitin 2004). Në kohën që nënshkroi kontratën me shoqërinë \*\*\*\* sh.p.k”, në vitin 2007, ka filluar të banojë në këtë apartament me bashkëshorten, djalin dhe prindërit e tij (pa përfunduar pallati, rreth fundit të vitit 2007 në dhjetor).

Për periudhën shtator 2000 - 2004, ka qenë me detyrë inspektor krimesh, në Vlorë, për rreth një vit e gjysmë ka jetuar në shtëpinë e oficerëve në Vlorë dhe nga periudha janar 2002 deri në qershor 2004, ka jetuar në ambientet e punës në Vlorë dhe për fundjavë shkonte me banim në shtëpinë e prindërve. Gjatë viteve 1996 deri në vitin 1999, ka qenë me studime në Akademinë e Rendit. Sqaroi se, përpara vitit 1996, si dhe pas përfundimit të shkollës deri sa ka marrë detyrën në Vlorë, ka jetuar në shtëpinë e prindërve.

Pasi ka blerë banesën tek firma \*\*\*\* sh.p.k”, ka jetuar në këtë apartament, në atë kohë kishte emërtimin rr. \*\*\*\*, dhe më vonë, kjo rrugë mori emrin \*\*\*\*. Ka jetuar në këtë shtëpi deri në janar 2019, pasi bëri mobilimin e shtëpisë tek \*\*\*\* sh.p.k”.

Referuar certifikatës personale në datë 14.02.2024, sqaroi se figuron i regjistruar në adresën rr. \*\*\*\*, Nd. \*\*, H. \*\*, Ap. \*\*, Njësia Administrative nr. 5, k.p. 1019, Tiranë, adresë e cila i përket apartamentit të cilin e ka deklaruar dhe banon aktualisht, nga muaji janar 2019. **Paraqiti:**

- Certifikatë personale në emër të Elton Alushi, i regjistruar në vendbanimin: \*\*\*\*, Nd. \*\*, H. \*\*, Ap. \*\*, Njësia Administrative nr. 5, k.p. 1019, Tiranë.

- Deklaratë datë 16.02.2024, me deklarues Xh. Sh, në të cilën deklaroi se ka në pronësi të tij apartament me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 91, 93 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, Tiranë ish - Fusha e Aviacionit. Në këtë apartament, nga muaji qershor 2004 deri në muajin dhjetor 2007, i'a ka dhënë z. Elton Alushi, në huapërdorje, pa kundërshtim. Bashkëlidhur, kartela e pasurisë së paluajtshme për apartament, me sip. 91, 93 m<sup>2</sup>, në emër të Xh. Sh, si dhe kopje të kartave Id.

### **Konkluzion:**

- *Subjekti dha shpjegime dhe paraqiti dokumentacion në lidhje me adresat e deklaruara dhe me vendbanimin ndër vite.*

### **Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dokumentacion:**

- Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 19.09.2016, me porositës Elton Alushi dhe palë porositës shoqëria “\*\*\* sh.p.k”, të apartamentit me sip. 133 m<sup>2</sup>, e përbërë nga tre dhoma e kuzhinë, në adresën rr. “\*\*\*\*”, objekti \*\*\*, në katin \*\*\*, në vlerën 65.000 euro. Porositësi do të paguajë shumën, pas shitjes nga ana e tij të një pasurie tjetër të paluajtshme në emër të tij. Paga do të shlyhet deri në përfundimin e apartamentit në datë 31.12.2017, me bankë.
- Akt marrëveshje nr. \*\*\*, datë 23.03.2018, për zgjidhjen vullnetare të kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 19.09.2016, me ndërtues shoqërinë “\*\*\* sh.p.k”, me palë porositës Elton Alushi. Nëpërmjet kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 19.09.2016, porositësi Elton Alushi ka porositur pranë shoqërisë ndërtuese “\*\*\* sh.p.k”, ndërtimin e një apartamenti me sip. 133 m<sup>2</sup>, në objektin nr. \*\*\*, kati \*\*\*, në adresën rr. “\*\*\*\*”. Porositësi do të paguante vlerën e kësaj kontrate deri në datë 31.12.2017, por deri në datën e sotme datë 23.03.2018, nuk është paguar asnjë këst për këtë kontratë porosie. Palët e zgjidhin kontratën dhe kthehen në gjendjen e mëparshme.

### **Procedura e vlerësimit:**

**Agjencia Shtetërore e Kadastrës,** nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të Elton Alushi.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjekti u pyet në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe deklarin.

Në procesverbalin e datës 16.02.2024, subjekti sqaroi se nuk është bërë ky deklarin, pasi ka menduar që bashkëlidhja e dokumentacionit, konkretisht, kontratë porosie dhe anulimit të saj, mjaftonte si deklarin. Është keqkuptuar nga ana e tij plotësimi i tij. Nuk ka pasur qëllim për të mos e deklaruar pasi nuk është bërë asnjë pagesë kundrejt firmës ndërtuese. Në lidhje me mos pasqyrimin e kontratës së porosisë në deklaratën periodike vjetore ka qenë pasi nuk ka kryer asnjë pagesë kundrejt firmës.

### **Konkluzion:**

- *Subjekti dha shpjegime në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe mos pasqyrimin në deklaratën vetting dhe ndër vite.*
- *Subjekti nuk ka kryer pagesë kundrejt firmës së ndërtimit “\*\*\* sh.p.k”.*
- *Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit.*

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruara nga subjekti, me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

- ✓ Në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri më datë 09.03.2023, është deklaruar në vlerën **rreth 14.367.000 lekë.**
- ✓ Të ardhurat neto të subjektit të vlerësimit nga pagat, shpërblimet etj., për periudhën shtator 2000 – mars 2023, konfirmohen në vlerën totale **rreth 17.383.000 lekë.**
- ✓ Të ardhurat neto të bashkëshortes së subjektit të vlerësimit, nga paga, shpërblimet etj., për periudhën 2003 – mars 2023, konfirmohen në vlerën totale **rreth 13.485.000 lekë.**

Gjithashtu si burim janë deklaruar:

- ✓ Të ardhura nga pagat dhe pensionet e prindërve për periudhën 1994 – 2010, të cilat arrijnë shumën **rreth 10.232.000 lekë.**
- ✓ Kredi Bankare në Tirana Bank, marrë në vitin 2007 në shumë **22.000 euro,** e shlyer.
- ✓ Shitja e tokës dhe shtëpisë së babait në vitin 2006, në shumën **1.000.000 lekë.**
- ✓ Shitja e tokës në Prush Tiranë, në shumën **800.000 lekë,** në vitin 2007, për të cilat nuk janë paguar detyrimet tatimore.
- ✓ Shitja e apartamentit në vlerën **7.200.000 lekë,** për të cilën nuk është paguar detyrimi tatimor për vlerën **767.376 lekë.**
- ✓ Kredi bankare në Raiffeisen Bank në vitin 2018, në shumën **800.000 lekë,** e shlyer.
- ✓ Huadhënia nga shtetasi Behar Cenaj, datë 20.08.2018, në shumën **950.000 lekë,** e likuiduar.
- ✓ Huadhënia nga shtetasi Admir Filaj, datë 17.09.2018, në shumën **15.000 usd dhe 6.000 euro,** e likuiduar.

Për periudhën 2000 – mars 2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar, **rreth 13.980.000 lekë.**

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet, në total **rreth 93.000 lekë.**

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, janë shpenzuar për udhëtime private të subjektit dhe personave të lidhur me të, në total **rreth 218.000 lekë.**

Për periudhën deri në ditën e dorëzimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për arsimin e subjektit dhe fëmijëve, në total rreth **353.000 lekë.**

Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë deklaruar shpenzime mobilimi, në total **rreth 800.000 lekë.**

### **Shkresat e institucioneve**

**Banka e Shqipërisë**, Banka Intesa Sanpaolo, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka Procredit, Banka Amerikane e Investimeve, Banka Union, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landesleasing, Raiffeisen Invest, Credins Invest, EasyPay, Fondi Besa, Institucioni Financiar NOA, Iutecredit Albania, Kredo Financë, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, çka konfirmohet me deklarin.

**Agjencia Shtetërore e Kadastrës - Drejtoritë dhe Zyrat Vendore** Tirana Rurale nr. 1, Tirana Rurale nr. 2, Tirana Veri, Zonat e Stimuluara Tropojë, Elbasan, Mirditë, Durrës, Tepelenë, Kukës, Fier Gramsh, Mallakastër, Korçë, Krujë, Peqin, Kamzë, Vorë, Skrapar, Librazhd, Pogradec, Malësi e Madhe, Kuçovë, Devoll, Lezhë Kavajë, Berat, Gjirokastrë, Përmet, Bulqizë, Pukë Kolonjë, Kurbin, Lushnjë, Dibër, Mat, Vlorë, Shkodër, Sarandë, nuk konfirmojnë pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

**Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon se Elsa Alushi ka llogari rrjedhëse me balancë në datën 09.03.2023, në vlerën 6, 781 lekë. Bashkëlidhur, nxjerrje llogari bankare.

**Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 02.10.2023, konfirmon se Elsa Alushi ka llogari rrjedhëse me balancë në datë 09.03.2023, në vlerën 7 euro dhe 3 euro. Bashkëlidhur, nxjerrje llogari bankare.

**Unioni Financiar i Tiranës**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.08.2023, konfirmon se Elsa Alushi ka tërhequr shumën 400 euro, nëpërmjet dy transfertave me jashtë, gjatë periudhës 27.07.2018 - 08.03.2023.

**Ak Invest**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon se në emër të shtetasit Elton Alushi, në datë 17.11.2010, ka tërhequr shumën prej 300 euro, me dërgues A. A, nga Italia.

Në procesverbalin e datës 01.02.2024, subjekti u pyet në lidhje me konstatimin e Unionit Financiar dhe Ak Invest.



Në procesverbalin e datës 16.02.2024, në lidhje me konstatimin e Unionit Financiar Tiranë, subjekti sqaroi se bashkëshortja ka marrë një shumë prej 400 euro, prej motrës së saj, A. F (jeton në Francë), ndihmë për prindërit.

Në lidhje me konstatimin Ak Invest, subjekti deklaroi me përgjegjësi të plotë se nuk ka lidhje me personin A. A dhe shumën e transferuar prej tij.

**Oendra Kombëtare e Biznesit**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon se Elton Alushi dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të jenë pajisur me NIPT, si persona fizik apo të zotërojnë kuota, aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar.

**Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, ka bashkëlidhur kopje të sistemit, ku Ylli Nezir Filaj figuron i regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier. Gjithashtu i kërkon Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, informacion në lidhje me shtetasin Elton Alushi dhe personat e lidhur me të.

**Drejtoria Rajonale Tatimore Fier**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.08.2023, përcjell informacion në lidhje me kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku konfirmon se shtetasi Ylli Nezir Filaj rezultoi i regjistruar si prodhues bujqësor “Fermer Ylli Filaj”, i identifikuar me NIPT M1\*\*\*2871S, me aktivitet prodhime bujqësore e blegtorale, me adresë Dames, Fratar, Mallakastër, me datë regjistrimi 12.03.2021, me status aktiv. Nuk ka të dhëna për shitje të realizuara nga fermeri. Bashkëlidhur, ekstrakt historik i tatimpaguesit “Fermer Ylli Filaj”, me aktivitet prodhime bujqësore e blegtorale.

**Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2023, konfirmon për shtetasit si më poshtë:

Ylli Filaj ka përfutur të ardhura nga punësimi pranë subjekteve “Komuna Fratar, Bashkia Ballsh, Asqeri Zeqaj”, për periudhën qershor 2012 - mars 2018 dhe korrik - gusht 2020. Gjithashtu, përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale nga shkurti 2018, në vlerën 30.398 lekë. Dafina Filaj përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale nga mars 2003, në vlerën 19.333 lekë.

**Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.01.2024, ka bashkëlidhur:

- Vërtetim për vjetërsi në punë për efekt pensioni nga Arkiva Qendrore, që konfirmon se Dafina Filaj ka qenë në marrëdhënie pune në sektorë të ndryshëm.
- Vërtetim për vjetërsi në punë për efekt pensioni nga Arkiva Qendrore, që konfirmon se Ylli Filaj, ka qenë në marrëdhënie pune në sektorë të ndryshëm për periudhën 1976 - 1996.

**Drejtoria e Arkivit Qendror**, me shkresat me nr. \*\*\* prot, datë 18.08.2023 dhe datë 03.01.2024, përcjell shkresën e Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, e cila informon se nga mënyra e administrimit dhe përpunimit të listë pagesave për periudhën 1994 - 2012, të punonjësve të siguruar në subjektet shtetërore, juridike apo fizikë, nuk mund të konfirmohet periudhë

kontributesh apo paga mbi të cilën janë siguruar, në qoftë se nuk jepet emërtimi i qendrës së punës, nipti i subjektit dhe personave të lidhur me të, fotokopje e librezës së punës.

Me vërtetim nr. 13357 prot., datë 28.12.2023, përcillen informacion për vjetërsinë në punë për efekt pensioni për shtetasit Dafina Filaj, Ylli Filaj.

**Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, nuk konfirmon mjet lundruar në pronësi të Elton Alushi dhe personave të lidhur me të.

**Regjistri Noterial Shqiptar, Ministria e Drejtësisë**, ka përcjellë informacionin për të gjitha veprimet dhe aktet noteriale të regjistruara në sistemin RNSH, për periudhën 01.03.2013 deri në datën 12.09.2023, të kryera nga noterë të ndryshëm për subjektin dhe personat e lidhur me të.

Nga verifikimi i të dhënave të vënë në dispozicion nga institucioni përkatës, konfirmohen të gjitha veprimet dhe aktet noteriale të kryera nga subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, gjatë periudhës 2013 – 2023.

### **Konkluzion:**


- *Subjekti dha shpjegime në lidhje me konfirmimet e Unionit Financiar dhe AK Invest.*
- *Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kanë sjellë informacion lidhur me punësimin dhe të ardhurat e prindërve të bashkëshortes së subjektit.*

**Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6, të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit, arrin në përfundimin se:**

- a) **deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interesi;**
- b) **nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;**
- c) **nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- d) **nuk është kryer deklarim i rremë;**
- e) **punonjësi nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.**

## **B. KONTROLI I FIGURËS**

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

 Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në këto elementë:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
- Procedura verifikuese nga Trupa e Vlerësimit që konsiston në:

- Verifikimin e informacioneve në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Identifikimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale;
- Analizimin dhe kryqëzimin e dokumentacionit të administruar, me deklaratimet e subjektit të vlerësimit.

## **Deklarimi i subjektit të vlerësimit**

### **Në deklaratën e kontrollit të figurës, subjekti i vlerësimit ka deklaruar se:**

- Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshortja, fëmijët, si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare, janë përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.

- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- Nuk ka vuajtur nga ç'rregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas Ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

### **Procedura verifikuese**

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaratimit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36 dhe nenit 37, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e tjera duke kërkuar të dhëna nga institucionet përgjegjëse, të shprehura në këtë ligj si më poshtë:

**Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**, për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 23.08.2023, bën me dije se nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve.

**Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**, me shkresë \*\*\*, prot., datë 22.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi, bën me dije se nuk rezulton i dënuar.

**Institucioni Ligjzbatues**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 31.08.2023, ka konfirmuar të dhëna referuese në ngarkim të subjektit të vlerësimit Z. Elton Alushi.

Nga verifikimi i kryer rezulton se të dhënat në ngarkim të subjektit të vlerësimit:

- Nuk rezulton të jenë ndarë me struktura të tjera ligjzbatuese;
- Nuk janë vërtetuar/dokumentuar;
- Nuk kanë vijueshmëri.

**Institucioni Ligjzbatues**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 01.09.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk ka të dhëna për cenimin e figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.
- Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autorit shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale.

- Nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka të dhëna nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s.
- Nuk ka të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka të dhëna nëse subjekti ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore në ngarkim.

**Institucioni Ligjzbatues**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 25.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi, bën me dije se nuk disponon të dhëna.

**Agjencia e Mbikëqyrjes Policore**, me shkresën e datës 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk disponohen ankesa, të dhëna apo informacione që lidhen me objektin e kërkesës.
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, viti 2016, në ngarkim të subjektit të vlerësimit Z. Elton Alushi, iniciuar nga kallëzimi i depozituar nga një përmbartues privat.

***Nga verifikimet ka rezultuar se, për sa më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, më datë 11.04.2016, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.***

- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, viti 2019, bazuar në materialin kallëzues që ka referuar Agjencia e Mbikëqyrjes Policore në ngarkim të subjektit të vlerësimit Z. Elton Alushi, i dyshuar për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

***Nga verifikimet ka rezultuar se, për sa më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.***

- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, viti 2019, në ngarkim të disa punonjësve policie, ndërmjet të cilëve edhe për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi, të dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Pas kryerjes së hetimeve paraprake në lidhje me këtë kallëzim penal, Prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2019, i cili vazhdon të jetë në fazë hetimi.

**Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi, bën me dije se:

- Nuk është pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) të vlefshme.
- Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore me shkresë nr. \*\*\*, datë 11.01.2022, ka shprehur vlerësimin përkatës drejtuar institucionit përgjegjës. Aktualisht është ende në proces.

Në kuadrin e procedurave të verifikimit të sigurisë për pajisjen me CSP të subjektit Z. Elton Alushi, për t’u njohur me informacionin e klasifikuar në nivelin “Tepër Sekret”, struktura përgjegjëse është

vënë në dijeni të të dhënave referuese në ngarkim të tij, dhe ka kryer procedura verifikuese, në përfundim të të cilave ka rezultuar se nuk konfirmohet vërtetësia e tyre, si dhe nuk është konfirmuar fakti i përfshirjes së tij në veprimtari kriminale.

Në përfundim të procesit verifikues, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, ka përcjellë pranë institucionit përgjegjës vlerësimin përkatës.

Trupa e Vlerësimit në kuadër të një hetimi objektiv dhe të gjithanshëm, me shkresën e datës 26.04.2024, i është drejtuar institucionit përgjegjës me qëllim informimin mbi ecurinë e procesit të verifikimit të sigurisë së personelit për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, me shkresën e datës 14.05.2024, bën me dije se Z. Elton Dilaver Alushi, është i pajisur me CSP të vlefshme, e cila mban nr. \*\*\*, niveli i klasifikimit “Tepër Sekret”, lëshuar më datë 31.01.2024, me afat vlefshmërie deri më datë 30.01.2029.

**Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar**, me shkresën nr. \*\*\*, prot., datë 30.08.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal,
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale,
- Nuk ka patur regjistrim të njoftimit të veprave penale,
- Nuk ka patur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

**Prokuroria e Përgjithshme**, me shkresën nr. \*\*\*, prot., datë 31.10.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal,
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale,
- Nuk ka patur regjistrim të njoftimit të veprave penale,
- Nuk ka patur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bën me dije se “...nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale, për periudhën kohore 2008 – 2023, rezultoi se në ngarkim të Elton Dilaver Alushi, i datëlindjes 17.05.1976, të jetë regjistruar:

- ✓ Kallëzimi penal nr. \*\*\*, viti 2019, për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, marrë vendim për mosfillim të procedimit penal më datë 13.06.2019.
- ✓ Procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2019, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, çështja vijon të jetë ende në fazë hetimi...”.

Sa i përket procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2019, Trupa e Vlerësimit ka kryer një hetim të plotë dhe objektiv, duke kërkuar informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, konkretisht lidhur me:

- 1- Ecurinë e këtij procedimi penal;
- 2- Sqarimin e pozitës procedurale të subjektit të vlerësimit, në këtë procedim penal;
- 3- Nëse subjekti i vlerësimit, ka marrë dijëni lidhur me procedimin penal në ngarkim të tij.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. \*\*\*, prot., datë 29.02.2024, duke bërë me dije se: “...nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikat të procedimeve penale, për periudhën kohore 2019 – 2023, rezultoi se procedimi penal nr. \*\*\*, viti 2019, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të jetë pa emër personi të regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Çështja vijon të jetë ende në fazë hetimi...”.

Lidhur sa më sipër, subjekti i vlerësimit është pyetur në seancën dëgjimore, nëse ka pasur dijëni apo është marrë në pyetje nga ana e Prokurorisë, lidhur me këtë procedimin penal.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar se nuk ka pasur dijëni dhe nuk është marrë në pyetje nga Prokuroria për këtë procedim.

**Avokati i Popullit**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 21.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit**, me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 24.11.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi, bën me dije se nuk ka qenë person në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm, si dhe anëtarë, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish – Sigurimi i Shtetit, deri në 2 korrik 1991.

**Agjencia e Inteligjencës Financiare**, bën me dije se për subjektin e vlerësimit Z. Elton Alushi, rezultuan raportime financiare, të cilat u verifikuan nga Trupa e Vlerësimit dhe u konstatua se ishin veprime bankare rutinë dhe jo të dyshimta.

**+** **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore, “Për kryerjen e ekspertimeve toksikologjike”, ka kryer ekspertimin toksikologjik të një mostre urine, mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike.

Me shkresë nr. \*\*\*, prot., datë 29.05.2024, protokolluar me nr. \*\*\*, prot., datë 31.05.2024, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka dërguar dokumentacionin përkatës, analizuar dhe vlerësuar nga Trupa e Vlerësimit, konkretisht:

- Akt Ekspertimi Toksikologjiko – Ligjor nr. \*\*\*, datë 27.05.2024 për subjektin e vlerësimit Elton Alushi.
- Deklaratë Eksperti

*Në bazë të rezultateve të përfituara nga ekspertiza toksikologjike për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se subjekti vlerësimit Z. Elton Alushi, aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.*

#### Denoncimet nga publiku

Nga verifikimet e kryera nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin/veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur.

#### Konkluzion:

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, arriti në konkluzionin se:

- *Lidhur me të dhënat referuese në ngarkim të subjektit të vlerësimit, rezulton se nuk janë ndarë me institucionet e tjera ligjzbatuese dhe nuk kanë pasur vijimësi, nuk janë të vërtetuara dhe dokumentuara, nuk ka fakte apo prova që subjekti i vlerësimit është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë që ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*
- *Subjekti i vlerësimit është pajisur me Certifikatë të Sigurisë së Personelit, më datë 31.01.2024, me afat vlefshmërie deri më datë 30.01.2029.*
- *Në ngarkim të subjektit të vlerësimit, janë regjistruar 3 kallëzime penale, nga të cilat për 2 prej tyre organi i Prokurorisë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, ndërsa për 1 është regjistruar procedimi penal i vitit 2019, pa emër personi, dhe vazhdon të jetë në fazë hetimi.*
- *Informacionet e ardhura nga institucionet përgjegjëse, përputhen me deklarin e subjektit.*
- *Nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur.*
- *Nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.*

Në konkluzion për vlerësimin e figurës, në përputhje me pikën 3, të nenit 42, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit, arrin në përfundimin se:

- a) punonjësi nuk ka kryer deklarin të rremë;
- b) nuk ka informacione, të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;



- c) **nuk ka informacion në deklarin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.**

## **C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

- ✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në këto elemente:
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
  - Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
  - Procedura verifikuese nga Trupa e Vlerësimit, e cila konsiston në analizimin dhe kryqëzimin e informacioneve të vëna në dispozicion nga institucionet përgjegjëse, me deklarin e subjektit të vlerësimit.

### **Deklarimi i subjektit të vlerësimit**

Në formularin e aftësive profesionale subjekti deklaron:

#### **Të dhëna për Arsimimin**

- Arsim i Lartë Policor, Akademia e Rendit Publik, Viti 1996 – 1999.
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti Juridik Tiranë, Viti 2011 – 2016.

#### **Procedura e vlerësimit:**

Subjekti i vlerësimit ka filluar studimet pranë Akademisë së Rendit Publik, në vitin 1996 dhe i ka përfunduar në vitin 1999. Në përfundim, institucioni arsimor përkatës, e ka titulluar “Specialist i lartë policie”, duke u pajisur me diplomën nr. 427 - A, datë 01.08.1999.

Në periudhën 2011 – 2016, subjekti i vlerësimit ka kryer studimet e larta në Fakultetin Juridik, Universiteti i Tiranës, dega Drejtësi, ku është diplomuar duke u pajisur me diplomën përkatëse nr.15783, datë 04.07.2016. Më datë 27.07.2017 është pajisur me diplomë të nivelit të dytë, në profilin “E drejtë penale”.

*Sipas legjislacionit për Policinë e Shtetit ndër vite dhe Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, Trupa e Vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe ushtron aktualisht.*

### **Të dhëna për punësimin dhe ecuria në karrierë**

Në pikat 2 dhe 3, të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcaktohet se “Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.

Neni 45, pika 2, shkronja (dh), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.

Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka në dispozicion dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit, në të cilën përfshihen akte të ndryshme që i përkasin arsimimit, punësimit, ngritjes në detyrë, gradimeve, kualifikimeve, vlerësimeve etj., të cilat janë marrë në analizë nga Trupa e Vlerësimit, me qëllim vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit, konkretisht:

- *Kopje e Urdhrit të emërimit nr. \*\*\*, datë 08.05.2017, për Kryekomisar Elton Dilaver Alushi, me detyrë Shef Komisariati, në Komisaratin e Policisë nr. 1, Tiranë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, për nevoja pune, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Shef Sektori/Specialist, në Sektorin për Krimet, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.*
- *Kopje e Urdhrit nr. \*\*\*, datë 03.11.2020, për Kryekomisar Elton Dilaver Alushi, me detyrë Shef Sektori/Specialist, në Sektorin për Krimet, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, për nevoja pune, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Shef Komisariati, në Komisaratin e Policisë Krujë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.*
- *Kopje e Urdhrit nr. \*\*\*, datë 02.11.2021, për Kryekomisar Elton Dilaver Alushi, me detyrë Shef Komisariati, në Komisaratin e Policisë Krujë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, për nevoja pune, të transferohet dhe të emërohet në detyrë Specialist ai dhe për statistikën, në Sektorin e Analizës së Riskut, në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Drejtimit, në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*
- *Kopje e Urdhrit nr. \*\*\*, datë 23.01.2023, për Kryekomisar Elton Dilaver Alushi, me detyrë Specialist ai dhe për statistikën, në Sektorin e Analizës së Riskut, në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Drejtimit, në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për nevoja pune, të transferohet dhe të emërohet në detyrë, Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë.*

Në formularin e aftësive profesionale, plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit, rezulton se 5 vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

Nga data 01.06.2017 – 05.11.2020, subjekti i vlerësimit Z. Elton Alushi ka ushtruar funksionin si Shef Sektori/Specialist, në Sektorin për Krimet, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, emëruar me Urdhër nr. 287, datë 19.05.2017.

Nga data 06.11.2020 – 01.11.2021, subjekti i vlerësimit Z. Elton Alushi ka ushtruar funksionin si Shef Komisarati, në Komisaratin e Policisë Krujë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, emëruar me Urdhër nr. 970/2, datë 03.11.2020.

Nga data 02.11.2021 – 22.01.2023, subjekti i vlerësimit Z. Elton Alushi ka ushtruar funksionin si Specialist ai dhe për statistikën, në Sektorin e Analizës së Riskut, në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Drejtimit, në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, emëruar me Urdhër nr. 1669, datë 02.11.2021.

Nga data 23.01.2021 dhe aktualisht, subjekti i vlerësimit ushtron funksionin si Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, emëruar me Urdhër nr. 181, datë 23.01.2023.

Nga verifikimi i akteve të administruara nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se subjekti i vlerësimit ka marrë gradën “Kryekomisar”, me Urdhër nr. 48, datë 12.01.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në zbatim të vendimit nr. \*\*\*, datë 09.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, marrë formë të prerë më datë 06.01.2017.

Grada “Kryekomisar”, korrespondon me funksionet që subjekti i vlerësimit ka ushtruar për periudhën 2017 – 22.01.2023, sipas përcaktimeve të VKM nr. 892, datë 21.12.2016 “*Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit*”.

Grada “Kryekomisar”, nuk korrespondon me funksionin që subjekti i vlerësimit ushtron aktualisht si Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi sipas përcaktimeve të VKM nr. 531, datë 29.07.2022 “*Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të policisë së shtetit dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese e kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, funksioni i Zëvendës drejtorit në Drejtorinë Vendore të Policisë, duhet ti përkasë gradës “Drejtues” dhe jo gradës “Kryekomisar”.

### **Vlerësimet e punës**

Në aktet e depozituara pranë strukturës përgjegjëse të burimeve njerëzore, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, rezulton se gjatë 5 viteve të fundit 2018 - 2021, janë të administruara 5 vlerësime të aftësive individuale të subjektit të vlerësimit Z. Elton Alushi, konkretisht:

- Për vitin 2018, është vlerësuar me 25 pikë;
- Për vitin 2019, është vlerësuar me 27 pikë;
- Për vitin 2020, është vlerësuar me 25 pikë;
- Për vitin 2021, është vlerësuar me 28 pikë;

## **Konkluzion:**

- *Nga analizimi i vlerësimeve të mësipërme, konstatohet se për periudhën 2018 – 2021, subjekti i vlerësimit është vlerësuar nga eprori i drejtpërdrejtë pothuajse me pikët maksimale.*
- *Nga verifikimet, ka rezultuar se për vitin 2022, nuk është administruar vlerësimi i punës në dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit.*

## **Përmbushja e detyrave të kryera dhe respektimi i rregullave të etikës**

Sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, neni 43, objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe përmbushja e detyrave nga punonjësi.

Gjithashtu në nenin 45, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, përcaktohet se aftësitë profesionale të punonjësit, vlerësohen duke u bazuar dhe në përshkrimet e punës për çdo funksion.

Nga verifikimi i dosjes së personelit si dhe në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 2018 – 2023, evidentohet një masë disiplinore me vërejtje, gjatë ushtrimit të funksionit të tij në Policinë e Shtetit, e konkretisht:

- Vendim nr. 30, datë 16.09.2021, e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, ku subjektit Elton Alushi, në atë kohë Kryekomisar, me detyrë Shef Komisariati, në Komisaratin e Policisë Krujë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, i jepet masë disiplinore “Vërejtje”.

Trupa e Vlerësimit, vlerëson se në bazë të legjislacionit të asaj kohe, specifiku Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, neni 96, pika 2, citohet se: “...Masa disiplinore “vërejtje” ose “vërejtje me paralajmërim”, shuhet pas kalimit të 6 muajve nga njoftimi i masës...”.

Si pasojë e kalimit të afatit respektiv 6 mujor, ku kjo masë është shuar, si dhe bazuar në kriteret e vlerësimit profesional të subjektit për 5 vitet e fundit, Trupa e Vlerësimit nuk i konsideron si elemente domethënës dhe penalizues në vlerësimin tërësor të anës profesionale të subjektit.

Në dosjen e personelit nuk ka asnjë të dhënë tjetër që të evidentojë ndonjë masë disiplinore të ndërmarrë ndaj subjektit, përtej viteve 2020 e deri në 2023, periudhë në të cilën subjekti ka ushtruar funksione të ndryshme dhe në rritje profesionale dhe me përgjegjësi të shtuara.

## **Konkluzion:**

*Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara në dosjen personale të subjektit, konkludojmë se subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.*

## **Kualifikimet dhe trajnimet:**

Nga verifikimi i dosjes së personelit të subjektit të vlerësimit kalimtar Z. Elton Alushi, si dhe formularit të aftësive profesionale të plotësuar nga subjekti, rezulton se për periudhën objekt

vlerësimi, nuk është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit (2018-2023), por rezulton se i është dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit certifikatë për shërbime të dalluara.

### **Konkluzion:**

Në përfundim të verifikimeve të kryera nga Trupa e Vlerësimit lidhur me vlerësimin profesional arrihet në konkluzionin se:

- *Subjekti i vlerësimit, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor dhe kualifikimit përkatës për funksionin që ka ushtruar dhe ushtron aktualisht.*
- *Funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.*
- *Për periudhën objekt vlerësimi, subjekti i vlerësimit është vlerësuar pozitivisht nga eprori i drejtpërdrejtë.*
- *Për vitin 2022, nuk është administruar vlerësimi i punës në dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit.*
- *Subjekti i vlerësimit nuk është pajisur me certifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit (2018-2023), por rezulton se i është dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit certifikatë për shërbime të dalluara.*
- *Grada “Kryekomisar”, nuk korrespondon me funksionin që subjekti i vlerësimit ushtron aktualisht si Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimeve të VKM nr. 531, datë 29.07.2022, fakt i cili nuk e penalizon subjektin e vlerësimit sa i përket aftësive profesionale.*
- *Subjekti i vlerësimit ka përmbushur detyrat profesionale dhe respektuar rregullat e etikës gjatë kryerjes së detyrave funksionale.*

Në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1, të nenit 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit, arrin në përfundimin se:

- a) është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
- b) ka vlerësime pozitive pune;
- c) ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.

### **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR:**

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha provat dhe shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, në përfundim të procesit të vlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, Elton Dilaver Alushi, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku tre kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollin e figurës;
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale;

### **PËR KËTO ARSYE:**

Trupa e Vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, pasi u mbloodh në dhomë këshillimi, në mbështetje të shkronjës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës “1” dhe “2” të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit Elton Dilaver Alushi, me detyrë Zëvendësdyrëtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
1. Vendimi i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

*Ky vendim u shpall sot më datë 19.09.2024, në Tiranë.*

### **TRUPA E VLERËSIMIT**

**KRYESUESE**

**Bora VRENJO**

**RELATOR**

**Henri NAQELLARI**

**ANËTARE**

**Loreta HANXHARI**